



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KKRT-KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Rruga: "Abdi Toptani", Tirane

Tel/ +355 42 333 26

Fax/ +355 42 262 87

e-mail/ kkrt@kkrt.gov.al

Nr.135 Prot

Tirane, me 03/02/2004

LENDË: Raporti mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003

KUVENDIT TE SHQIPERISE

Komisionit te Perhershëm per Mjetet e Informimit Publik

Z. Musa ULQINI, Kryetar

Tirane

Ne pergjigje te shkreses suaj nr. 44, date 12.01.2004, bashkelidhur ju
dergojme "Raportin mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003".

K R Y E T A R I

Sefedin ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KKRT-KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Rruga: "Abdi Toptani", Tirane

Tel/ +355 42 333 26

Fax/ +355 42 262 87

e-mail/ kkrt@kkrt.gov.al

Nr. 135 Prot

Tirane, me 03/02/2004

LENDË: Raporti mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003

KUVENDIT TE SHQIPERISE

Z. Servet PELLUMBI
Kryetar

Tirane

Ne pergjigje te shkreses suaj nr. 44, date 12.01.2004, bashkelidhur ju dergojme "Raportin mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003".

K R Y E T A R I

Sefedin ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KKRT-KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Rruga: "Abdi Toptani", Tirane

Tel/ +355 42 333 26

Fax/ +355 42 262 87

e-mail/ kkrt@kkrt.gov.al

Nr. ____ Prot

Tirane, me 03/02/2004

LENDË: Raporti mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003

**PREZENCES SE OSBE-se
Zyres se Shtypit
Tirane**

Bashkelidhur, ju dergojme "Raportin mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003", i cili u miratua ne mbledhjen e Keshillit te KKRT-se, ne date 30 Janar 2004.

K R Y E T A R I

Sefedin ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KKRT-KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Rruga: "Abdi Toptani", Tirane

Tel/ +355 42 333 26

Fax/ +355 42 262 87

e-mail/ kkrt@kkrt.gov.al

Nr. ____ Prot

Tirane, me 03/02/2004

LENDÄ: Raporti mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003

**AMBASADES SE SHBA-se
Zyres se Shtypit
Tirane**

Bashkelidhur, ju dergojme "Raportin mbi veprimtarine e KKRT-se per vitin 2003".

K R Y E T A R I

Sefedin ÇELA

KKRT – 2003

1. Raport vjetor ne Kuvendin e Shqiperise

- Hyrje, faqe 1
- Programet radiotelevizive – drejt standarteve profesionale, faqe 2-8;
- Administrimi i Frekuencave dhe teknologjite e reja, faqe 9-25;
- Probleme te buxhetit per 2003 dhe 2004; detyrimet e operatoreve radiotelevizive, faqe 26-30;
- Konkluzione, faqe 31-32;

2. Plani i Veprimit 2004

3. Mbulimi i operatoreve rtv deri ne fund te vitit 2003 (Aneksi 1)
4. Mbulimi i realizuar nga operatoret TV ne fund te vitit 2003 kundrejt vitit 2002 (Aneksi 2.1)
5. Mbulimi i realizuar nga operatoret Radio FM ne fund te vitit 2003 kundrejt vitit 2002 (Aneksi 2.2)
6. Ndryshimet ne mbulimin me sinjal te realizuar nga operatoret TV kundrejt vitit 2002 (Aneksi 3)
7. Pasqyra e te dhenave statistikore mbi llojet e programeve te transmetuara nga disa TV gjate vitit 2003
8. Pasqyra e çeshtjeve gjyquesore per vitin 2003
9. Pasqyra e gjobave per vitin 2003
 - (Raport i permbledhur i çeshtjeve gjyquesore)
10. Pasqyra e detyrimeve te operatoreve radiotelevizive per vitin 2003

KKRT – 2003

- Raport Vjetor ne Kuvendin e Shqiperise -

• Hyrje

Shqyrtimi i nje viti veprimtarie ne median elektronike, si viti 2003, shtrirja e saj dhe rritja e prezences, si numer operatoresh, si sinjal dhe si informacion ne te gjithe territorin e vendit, plotesimi perhere e me i mire i standarteve ne fushen e programeve, te te drejtave te transmetimit, te teknologjive, por edhe te stafeve krijuese e teknike, flasin per konsolidim e qendrueshmeri ne tregun e mediave ne teresi, flasin per konsolidim edhe te KKRT-se, monitorues e rregullator i kesaj veprimtarie.

Pavaresisht se mediat elektronike, perveç operatorit publik, jane biznese, KKRT ka patur kurdohere parasysh se ato, njekohesisht jane pasqyre e proceseve demokratike, dimension i domosdoshem i nje shoqerie te hapur, pra, sjellja ndaj tyre dhe problemeve me to jane pare me tolerance maksimale, duke aplikuar zgjidhjet ne mirekuptim, paralajmerimet e sanksionet e tjera, ne kufijte e ligjit.

Arritje te tilla si respektimi thuajse nga te gjithe operatoret radiotelevizive i te drejtave te transmetimit, i paraqitjes se programeve me foles, titra apo dublim ne shqip, shlyerja e detyrimeve financiare nga nje numer perhere e ne rritje operatoresh, si dhe pranimi prej tyre i domosdoshmerise per rialokimin e frekuencave qe interferojne, siç tregon Harta e Frekuencave dhe programimi i zgjidhjeve te paraqitura nga KKRT per te rregulluar gjendjen e renduar, te gjitha keto tregojne per zhvillime inkurajuese, te mbara, per operatoret e KKRT-ne, por probleme te tjera jane ende teper te mprehta.

Mediat e lira, posaçerisht ato elektronike, jane si nje qenie qe, per te qendruar drejt, u duhet domosdoshmerisht te mbeshteten ne dy kembe: ligji dhe tregu. Harmonizimi i ketyre dy gjymtyreve ne çdo hap do ta bente median te ece e lire, realisht e pavarur.

Burimet e pamjaftueshme qe siguron tregu i varfer e kaotik, posaçerisht ai i medias – pra reklama, e perpjestuar ne nje numer te madh operatoresh, probleme te keqmenaxhimit edhe nga mungesa e pervojes, kompromentojne edhe sjelljen e respektin ndaj ligjit. Perballimi i ketyre problemeve, per te garantuar ecjen e sigurt te mediave, kerkojne perpjekje te perbashketa nga vete komuniteti e nga rregulatori, si edhe nga ligjvenesi. Keto probleme do te jene objekt i ketij raporti, i informacionit plotesues dhe i Planit te Veprimit (bashkelidhur) per vitin 2004, te cilat ia propozojme ketij Kuvendi te larte t'i miratoje.

1. PROGRAMET RTV – DREJT STANDARTEVE PROFESIONALE

Gjate vitit 2003, ne fushen e programeve dhe standarteve programore u percaktuan objektiva te qarta ligjore dhe profesionale.

Puna u perqendrua ne keto drejtime kryesore:

- **Zbatimi i ligjit kunder piraterise: Respektimi i te drejtave te transmetimit dhe te drejtave te autorit.**
- **Monitorimi i programeve informative te operatorve publike dhe kombetare.**
- **Pasqyrimi nga media elektronike i Fushates Zgjedhore Tetor 2003.**

1.1 Pirateria Radiotelevizive

Minimizimi i piraterise ne veprimtarine radiotelevizive, ka qene nje problem i ndjekur ne vazhdimesi nga Keshilli Kombetar i Radios dhe Televizonit, qysh ne krijimin e tij. Eshte fakt qe media elektronike shqiptare rendom piratonte programe radiotelevizive. Ne kushtet e tronditjeve te medha si viti 1997 e me vone, nuk mund te nderhyej me sanksione ndaj medias elektronike, qe piratonte programe raiotelevizive e bashketet me piraterine, kur shteti dhe institucionet s'kishin ende ne kontroll doganat, dhe kur ekzistanca e ketyre mediave, ashtu pa leje e rregull siç kishin dale, ishte me e dobishme per zhvillimet demokratike, sesa mbyllja “e ligjshme” e tyre.

KKRT e ndertoi punen e vet kunder piraterise, duke ndjekur disa fazat te natyrshme dhe te pranueshme per mjedisin mediatik. Fillimisht u konsiderua si një proces qe duhet perballuar jo me sanksione, por si konflikt midis paleve, duke mbrojtur ne rruga gjyquesore secili te drejtat e veta. Ndjekjen e rruges gjyquesore e percakton aktualisht edhe ligji. Ne fakt kjo eshte rruga qe duhet te ndiqet edhe ne te ardhmen.

Fillimisht u synua ne respektimin e te drejtave te transmetimit te programeve radiotelevizive te blera nga vete operatoret. Ketu perfshiheshin te drejtat e transmetimit te veprimtarive sportive si futboll, automobilizem etj, si dhe te ekranizimeve te ndryshme si filma artistike dhe televizive, telenovela etj.

Shume shpejt u arrit qe te respektoheshin keto te drejta, dhe ne ekranet shqiptare te zhdukej dukuria amatoreske, ku nje ndeshje nderkombetare sportive transmetohej nga 10 operatore ne te njejten kohe, ose ne nje ekran te shihnim po ate film qe pame nje ditë me pare ne nje ekran tjeter. Televizonet filluan te ndanin vete tregun e transmetimeve sportive, treg qe edhe aktualisht ka nje audiencve te madhe. Ne te njejten menyre, por jo me te njejtin temp dhe force, u veprua edhe me transmetimin e filmave artistike.

Me kalimin e kohes KKRT-ja u vu perballe kerkesave te operatoreve qe prisin garantimin e konkurrencës se ndershme edhe ne fushen e transmetimit te programeve, kerkese e bazuar ne nenin 7/4 te Ligjit “Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republikën e Shqiperise”.

KKRT-ja jo vetem e priste nje reagim te tille, por ishte e perqatitur ta perballonte juridikisht problemin, duke propozuar dhe paraqitur ne Komisionin Parlamentar te Medias amendamentet perkatese per vendosjen e sanksioneve per programe te piratuara.

E çmojme ne kohe dhe si akt emancipues nismen dhe kembenguljen e disa operatoreve per miratimin ne Kuvend te ligjit me amendamentet ne fjale, per ta bere efikase lufsten kunder piraterise.

KKRT, menjehere miratoi aktet nenligjore perkatese dhe organizoi punen per zbatimin e Ligjit nr. 9124, dt. 29.07.2003, qe detyron operatoret radiotelevizive te jalin vetem programe me te drejta te plota transmetimi, nepermjet te ciles synohej ne dy arritje kryesore, qe jane nje pjese e garantimit te konkurrences se ndershme ne median elektronike:

- T'i pritet rruga piraterise radiotelevizive
- Te mbrohen te drejtat e autorit.

Zbatimi i Ligjit nr. 9124, dt. 29.07.2003, parashikon sanksione per ata operatore radiotelevizive, qe transmetojne programe pirate. Keto sanksione variojne nga 200.000 deri ne 1.000.000 leke. Perserita e kesaj shkeljeje me shume se 5 here denohet me uljen deri ne 50% te afatit te licenses, e me pas shkelja denohet me heqjen e licenses. Sipas ketij ligji, subjektet radiotelevizive jane te detyruar te depozitojne ne KKRT dokumentacionin qe verteton se zoterojne te drejtat e transmetimit te programeve.

Menjehere pas miratimit te ligjit, qe ne muajin Gusht 2003, KKRT hartoi dhe miratoi "Rregulloren mbi depozitim e dokumentacionit per te drejten e transmetimit", e cila iu be e njobur te gjithe operatoreve radiotelevizive, u publikua ne median e shkruar, si dhe ne faqen e internetit te KKRT-se.

Zbatimi praktikisht i ligjit, pra vendosja e sanksioneve u vendos te filloje nga data 15 Tetor, per t'u lene kohe operatoreve te depozitojne ne KKRT dokumentacionin e kerkuar, per te marre masa per te siguruar programe te reja te produhuara vete, apo te blera e dhuruara, qe te shmangej vakumi ne strukturat programore, por edhe pse infrastruktura e monitorimit ishte e okupuar sipas detyrimit ligjor te Kodit Zgjedhor, me monitorimin e fushates se zgjedhjeve vendore 2003.

KKRT pershendet te gjithe ata operatore radiotelevizive qe iu perqigjen kerkeses per te transmetuar programe me te drejta te plota transmetimi, duke treguar ne kete menyre profesionalizem dhe disipline ne zbatimin e ligjit.

Nga Departamenti i Programeve ne KKRT, u krye monitorimi dy-mujor i programeve te operatoreve radiotelevizive, proces i nderlikuar, qe kerkonte nje ekip monitoruesish dhe nje kosto jo te vogel financiare. Ekipi u perzgjodh me kujdes dhe u trajnua posaçerisht. Jane vendosur edhe sanksionet e para, per ata operatore qe pas 15 Tetorit, ende transmetonin programe te paligjshme, pra pa te drejta transmetimi. Jane gjobitur "Tv Shijak", "Telenorba Shqiptare", "Tv Koha", "AVN", "Skampa", "Alsat" etj. Jane ne ndjekje te procedurave per verifikimin e ligjshmerise se transmetimeve te tyre edhe disa operatore te tjere (shih pasqyrat per gjobat). Pas fazes se pare te monitorimit te programeve televizive te operatoreve, sinjali i te cileve shihet ne Tirane, u kalua ne monitorimin e programeve te televizioneve te rretheve, e me pas edhe ne monitorimin e stacioneve radiofonike. Funksionimi ligjor i stacioneve radiofonike mund te zgjidhet shume shpejt si ne gjithe boten, sidomos per programet muzikore, pas nenshkrimit te kontratave me shoqatat per mbrojtjen e te drejtave te autorit, kontrata qe duhen nenshkruar edhe me operatoret televizive.

Theksojme se, pavaresisht problemeve qe kane dale per cilesine e programeve, ato jane kalimtare, ligji po zbatohet masivisht, shenje kjo e konsolidimit professional te kesaj veprimtarie edhe si bisnes.

I rendesishem eshte fakti qe tani **Shqiperia nuk eshte më nje vend me pirateri radiotelevizive**, nuk eshte më vendi ku televisionet e licensuara ishin kthyer ne perserites

te thjeshte te operatoreve te huaj satelitore. Permiresimet ne cilesine e programit pritet te behen gradualisht.

Pronaret dhe administratoret e medias elektronike tani mendojne se si te prodhojne vete programe, dhe jo si t'i piratojne ato. Eshte tejkaluar momenti kur nje televizion lidhej me nje kanal satelitor e piratonte me ore te tera, duke anashkaluar faktin se konkurrente ne menyre te pandershme, duke shkelur te drejten e transmetimit dhe njekohesisht te drejtat e autorit.

Me te dhenat e nxjerra nga monitorimi i programeve radiotelevizive, KKRT ka hartuar edhe nje pasqyre te qarte te struktures programore per te gjithe operatoret kryesore televizive, ku perfshihen te dhenat statistikore per llojet e ndryshme te programeve, pjesen e programeve te produhuara vete, burimin e sigurimit te ketyre te emisoneve, gjuhen e perdorur, vendin qe ze publiciteti ne gjithe programin e transmetuar etj.

Keto te dhena u jane bere te njoitura edhe vete operatoreve televizive, si material studimor dhe reflektues per permiresimin e treguesve permbajtesore te transmetimit ne te ardhmen.

* Shih pasqyren nr. 1 mbi te dhenat statistikore per llojet e programeve te transmetuara nga disa TV gjate vitit 2003.

Ne fushen e programeve tashme eshte ezauruar problemi i **perdorimit te gjuhes shqipe**, kerkese e nenit 37 te Ligjit “Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise”.

Tashme per KKRT-ne nuk perben problem nje fenomen i tille, pasi gati te gjithe operatoret i kane marre masat per te transmetuar ne gjuhen e percaktuar ne ligj. Mbetet nje problem shqetesues fakti i shtremberimit dhe i keqperdorimit te gjuhes shqipe. Per kete kerkohet angazhimi i gjithe stafeve te specializuara te radiove dhe televizioneve, por edhe i specialisteve qe nuk mungojne ne Bordet Drejtuese te subjekteve te licensuar nga KKRT. Fenomini i deformimit te gjuhes shqipe ne radio dhe televizion nuk mund te zgjidhet thjesht, aq me pak me sanksione.

Ne fushen programore po rishfaqet ne forme te re, fenomeni i perdorimit pa kriter te linjes 0900..., te perfolur, por edhe te trajtuar me seriozitetin e duhur nga KKRT.

Ka nje vendim te posaçem te KKRT-se per kete problem, ku lejohet perdorimi i sherbimit telefonik me vlere te shtuar nga ora 24.00 deri 06.00 vetem ne programet reklame dhe emisionet konkurse apo bashkebisedime me publikun. Vendimi i KKRT-se eshte zbatuar ne per gjithesi nga operatoret rtv, por ndodh qe organizohen konkurse me oferta marramendese e me pyetje elementare per t'iu per gjigjur, me qellim qe te thithin nje numer te madh telefonuesish, qe, ne me te shumten e rasteve, humbasin parate nepermjet bisedave telefonike, se sa behen pjese aktive e programit konkurs te transmetuar. Me gjithe vleresimin e ketij problemi, KKRT e shikon te veshtire nderhyrjen ne kete biznes, kur ka organizma te tjera qe i kane licensuar si bisnese, dhe te tjera qe kane detyre te mbrojne konsumatoret.

Krahas ketyre emisioneve, qe kane synim dhe ndikojne ne buxhetin e operatoreve televizive, jane transmetuar programe dinjitoze nga shume operatore, ku mund te permendim “ Maratona e kenges populllore”, “Nete vere 2003”, dhe “Kombinat Show” ne Tv Klan, “Ethet e se premtes mbrema” pergatitur nga Telesport e transmetuar edhe nga

TVSH, "Shqip", "Auditorium" dhe "Fix Fare" ne Top Channel, "Kontrast" ne Alsat, "Histori pa montazh" "Friends", "Quiz +", "Ups...", "SOS..." ne "Vizion +", "Splash" dhe "Format" ne TVA, "Argument" ne Tv Koha, mjaft rubrika sportive dhe sociale perseri ne Telesport etj.

1.2 Monitorimi i programeve informative te operatoreve publike dhe kombetare

Detyrimi i percaktuar ne nenin 7/2 te ligjit Nr. 8410, date 30.09.1998, "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperse", qe ka te beje me monitorimin e programeve informative te transmetuesve kombetare, eshte pare me perparesi nga KKRT, gjate vitit 2003. Ky monitorim eshte kryer deri ne muajin Shtator vetem per transmetuesit kombetare. Ne periudhen Shtator-Tetor 2003 u realizua monitorimi i programeve informative edhe te operatoreve te tjere televizive, ne kuadrin e funksionimit ligjor per pasqyrimin e fushates per zgjedhjet e pushtetit lokal. Ndersa ne muajt Nentor-Dhjetor, studio e Monitorimit u perdor per realizimin e monitorimit te programeve te te gjithe transmetuesve televizive, ne kuadrin e luftes kunder piarterise.

U monitoruan programet informative te Televizionit Shqiptar, Televizionit Klan dhe Televizionit Arberia, sipas nje moduli te miratuar dhe te njejtë per te tre operatoret kombetare. Si rregull, monitorimi u shtri ne edicionet kryesore te lajmeve dhe rubrikat e aktualitetit te transmetuara gjate vitit 2003.

Monitorimi konsistonte ne percaktimin e te dhenave statistikore per tema te tilla si politika, ekonomia, veprimtaria e qeverise, veprimtaria e parlamentit dhe institucionit te presidentit, arsimi, kultura, kronika e zeze, biznesi etj.

Ne Televizionin Shqiptar, tema kryesore e trajtuar ne edicionet e lajmeve ka qene "politika" me rreth 20% te kohes se per gjithshme te lajmeve, ashtu si edhe nje vit me pare. Tema "Lajme nga bota" renditet ne vend te dyte dhe "veprimtaria e qeverise" e treta. Nga TVSH eshte arritur nje pasqyrim i ekuilibruar per veprimtarine e partive te koalicionit qeverises dhe partive opozitare gjate edacioneve informative. Informacioni ka qene i larmishem dhe jane zbatuar me profesionalizem kerkesat e ligjit per paanesine dhe paraqitjen e drejte te fakteve dhe ngjarjeve.

Radiotelevizioni Publik Shqiptar duhet te programoje, perqatisse dhe transmetoje me shume emisione me karakter edukativ, kulturor, artistik dhe argetues, per te mbushur nje boshlek te krijuar ne ekranin e vet per keto emisione gjate vitit 2003, si detyrim ligjor te shprehur ne nenin 35 te Ligjit "Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise". Ne baze te kompetencave te veta, kete problem kerkohet ta analizoje dhe zgjidhe, Keshilli Drejtues i RTSH-se.

Ne Televizionin Kombetar "Klan", jane 2 tema kryesore qe kane zene pothuajse te njejten hapesire kohore ne edicionet informative: "lajme nderkombetare" dhe "politika". Koha per pasqyrimin e veprimtarive te partive te koalicionit qeverises dhe partive te opozites, ka qene e alternuar nga nje muaj ne tjetrin, here ne favor te njerit dhe here ne favor te tjeterit formacion politik.

Eshte per tu theksuar fakti, se ne emisionet e aktualitetit "Opinion" dhe "Apostrof", te transmetuar nga "Tv Klan", forcat politike jane perfaquesuar ne menyre te balancuar dhe pjesemarrja ne te, ka qene me perfaquesues te te gjitha ngjyrave politike.

Ne lajmet e Televizionit Kombetar "Arberia", tema "lajme nderkombetare" eshte per gjithesisht me e trajtuara gjate edacioneve informative dhe se ciles i dhene me

shume kohe ne pasqyrim. Ne vend te dyte renditet tema “politika”, e pas saj “veprimtarite e qeverise”. Ne TVA, pasqyrimit te veprimtarive te partive te koalicionit qeverises dhe partive opozitare i eshte dhene pothuajse kohe e barabarte.

Nje vend te rendesishem dhe ne periudha specifike, tema “kronika e zeze” ka zene nje vend te konsiderueshem ne televizionet kombetare.

Ne te tre televizionet e siperpermendur, temat sociale kane gjetur gjithmone e me shume nje hapesire me te madhe, gjate edicioneve te lajmeve. Por eshte dukuri specifike e televizioneve tona, jo vetem atyre kombetare, dhe jo vetem televizioneve, qe rendin pas mbledhjeve te partive ne qender dhe ne baze, ne periudha fushatash apo jashte tyre, duke kaluar perceptazi dhe ne menyre sporadike problemet e mprehta sociale. Pasqyrimi i mbledhjeve te partive neper rrethe, qe vetem ne Shqiperi perbejne lajm, kerkon me shume shpenzime financiare, sidomos kur rendet pas liderave dhe kerkon pak profesionalizem, pasi citohen deklaratat, ndersa shtrimi i nje problemi social ekonomik kerkon intuiten, origjinalitetin dhe gazetarin investigues, qe media elektronike ende i ka te paket. Ne te njejten forme jo profesionale trajtohet ne ekran edhe “kronika e zeza”, shpesh here duke shkelur dhe abuzuar me normat etike dhe deri tek te drejtat e individit.

Ne Televizionin Publik Shqiptar dhe ne dy televizionet private kombetare, aktoret sinkron me te perfaquesuar kane qene lideret e partive me te medha politike. Edhe subjektet sinkron me kohen me te madhe ne dispozicion, jane keto parti si dhe “qeveria”, qe kane zene hapesiren me te madhe kohore.

Radio “Tirana”, “Top Albania Radio” dhe “Radio +2” jane perfektisht profesionalist dhe kane zbatuar kerkesat e ligjit per te paraqitur faktet dhe ngjarjet ne menyre te drekte dhe te paanshme, duke informuar me shpejtesi dhe nxitur formimin e lire te opinioneve, pa i sherbyer ne menyre te njeanshme partive apo interesave te grupimeve politike.

Tabelat e monitorimit dhe te dhenat e nxjerra prej tij, u jane bere te njoitura çdo muaj operatoreve radiotelevizive te monitoruar, institucioneve nderkombetare qe merren me problemet e medias ne vedin tone, si dhe vete Komisionit Parlamentar te Medias.

Roli i medias elektronike ne informimin e drekte dhe te paanshem te publikut, eshte nje detyrim ligjor jo vetem per transmetuesit kombetare, por edhe per radiot dhe televizionet lokale, qe luajne nje rol te rendesishem ne trajtimin e temave, qe paraqesin interes per komuniteten. Permendim sipas rretheve “Tv Rozafa” ne Shkoder, “Tv Puka”, “Tv Mati”, “Tv 6+1” ne Vlore, “ETV” ne Elbasan, “Sot 7” e “ARV” ne Pogradec etj, si dhe radiot “Vale e kalter” ne Vlore, “Alpo” ne Gjirokaster, “Radio Saranda”, “ABC” dhe “Magic Radio” ne Korçe, “Perla” ne Durres, “Radio Fieri”, “Radio Prespa”, “Radio e Pare” ne Mat etj.

Edicionet e lajmeve jane programet me te konsoliduara ne strukturen programore te operatoreve radiotelevizive. Permendim televizione te tilli si “Top Channel”, “Alsat”, “TNSH”, “Vizion +”, “Koha Tv”, “Tv Teuta”, “ETV”, “Dardan TV”, “Real TV” etj.

1.3 Pasqyrimi nga media elektronike i Fushates Zgjedhore Totor 2003

Me afrimin e zgjedhjeve per pushtetin vendor te Totorit 2003, KKRT morri te gjitha masat perqatitore per t’iu pergjigjur kerkesave te ligjit “Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne RSH” dhe “Kodit te ri Zgjedhor”, i cili e ngarkonte me detyra te tjera specifike KKRT-ne, per monitorimin e pasqyrimit nga media elektronike te kesaj fushate

zgjedhore. E nje rendesie te vecante ishte vodosja dhe konsolidimi i marredhenieve institucionale midis KKRT-se dhe KQZ-se, bashkepunim qe do te ishte garanci per mbikqyrien e medias elektronike gjate fushates zgjedhore.

Qe ne muajin Korrik u formulua dhe iu dergua per konsultim te gjitha institucioneve te interesuara, “Kujtesa” e KKRT-se per te gjitha subjektet radiotelevizive qe do te pasqyronin fushaten zgjedhore te 12 Totorit 2003.

“Kujtesa” ishte nje permblehdje e kerkesave te ligjit Nr. 8410 dt 30.09.1998 “Per radion dhe televizionin publik dhe privat ne RSH” dhe Ligjet Nr. 9087 dt 19.06.2003 “Kodi zgjedhor ne RSH”. Gjate hartimit te “Kujteses” u paten parasysh kerkesat ligjore per programet informative, rregullat per pasqyrimin e fushates zgjedhore, normat etiko-profesionale dhe aspekte nga pervoja e deritanishme gjate fushatave zgjedhore.

Specialistet e Departamentit te Programeve ne KKRT jane vleresuar per ndihmesen dhe mbeshtetjen ne organizimin e seminareve disaditore te OSBE-se mbi rolin e mediave ne procesin zgjedhor.

Me afrimin e zgjedhjeve u nenshkrua marreveshja e bashkepunimit midis KKRT-se dhe KQZ-se “Per monitorimin e fushates zgjedhore”. Qellimi i kesaj marreveshje ishte angazhimi i paleve per percaktimin e rregullave, menyes dhe afateve te shfrytezimit te kapaciteteve teknike te KKRT-se, per nevojat e monitorimit.

KKRT vuri ne dispozicion te Bordit te Medias prane KQZ-se Studion e Monitorimit, qe eshte nje sistem kompjuterik i instaluar ne Departamentin e Programeve dhe i afte te regjistroje ne kohe reale te pakten 20 kanale televizive dhe 10 radiofonike. Studio e Monitorimit permban 10 vende pune, ku mund te perpunohet i gjithe materiali i regjistruar dhe i grumbulluar ne 2 servera te fuqishem.

Gjate monitorimit u shfryteza pervoja e deritanishme e grumbulluar nga KKRT-ja ne 3 fushatat e fundit zgjedhore

Monitorimi i medias elektronike per pasqyrimin e fushates zgjedhore 2003, u krye sipas metodikes se realizuar dhe modulit te propozuar nga KKRT, te miratuar nga Bordi i Monitorimit te Medias dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Nga specialistet e Departamentit te Programeve u krye gjate nje jave edhe trajnimi i grupit te monitoruesve te percaktuar nga KQZ.

Media elektronike realizoi nje pasqyrim korrekt, profesional dhe ligjor te fushates zgjedhore, proces qe u vleresua nga forcat politike pjesemarrese ne zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe organizmat nderkombetare qe monitoruan fushaten per zgjedhjet e pushtetit vendor te 12 Totorit 2003.

Nga rezultatet e monitorimit te kryer ne studiot e KKRT dhe shqyrtimi i ankesave dhe raporteve te paraqitura prej Bordit te Monitorimit te Medias ne KQZ, mund te deklarohet se ky pasqyrim ishte me profesionali i arritur deri tani nga media elektronike.

1.4 Keshilli i Ankesave – probleme te etikes

Viti 2003, per Keshillin e Ankesave, ka qene viti i trete i veprimtarise se ketij Keshilli, si institucion i specializuar per problemet etike e morale prane KKRT-se.

Gjate ketij viti jane botuar dy numra te buletinit “Antena” (5, 6) dhe eshte ne perqatitje numri 7. “Antena” ka pasqyryar permes rubrikave te saj, te gjithe veprimtarine e Keshillit te Ankesave per problemet etike dhe morale te medias elektronike ne territorin e Shqiperise dhe ka sherbyer si nje literature metodike, teorike e praktike, per operatoret

dhe stafet mediatike, duke aktivizuar here pas here autoritete shkencore te vendit me trajtesa te karakterit social, psikologjik dhe linguistik, qe lidhen me moralin dhe etiken e medias elektronike. Te tilla kane qene artikujt e botuar tek “Antena” nga Artan Fuga, Ylli Pango, Zyhdi Dervishi, Gjovalin Shkurtaj, Rasim Gjoka, Remzi Lani etj.

Eshte per t'u theksuar se, per here te pare ne Shqiperi, po krijohet nje literature e orientuar per probleme specifike te medias elektronike. Ketu duhet shtuar edhe kontributi qe sjell ky buletin me rubriken ne vazhdim, qe nga numri i pare “Pervoja e huaj”, ku vendin kryesor e ze pervoja e standarteve te etikes se BBC-se, Kijkwijzeri i Hollandezeve, shenjat paralajmeruese te francezeve etj.

Gjate kohes qe raportojne ka perfunduar anketa e trete ne shkalle vendi “Etika ne mediat elektronike”, qe realizohet ne bashkepunim me nje institucion me pervoje disavjeçare per anketime, sic eshte Fondacioni per Zgjidhjen e Konflikteve dhe te Mosmarreveshjeve. Tanime eshte krijuar nje dokumentacion i tere, qe pasqyron ndjeshmerine e publikut shqiptar ndaj keqperdorimit te dhunes dhe seksit ne ekran, duke filluar nga viti 2001. Ky dokumentacion i perpunuar eshte botuar ne buletinin “Antena” dhe ka sherbyer per sensibilizimin e opinionit publik per rritjen e pergjegjesise se operatoreve transmetues, por ne te ardhmen do te mbetet edhe si pike referimi per studime krahesuese te ndikimit te medias ne jeten sociale dhe efektet psikologjike te saj ndaj grupmoshave te popullsise. Ketij qellimi i kane sherbyer edhe studimet e publikuara ne buletin dhe organet e tjera te shtypit, te realizuara nga Keshilli i Ankesave pas çdo anketimi.

Perveç kontaktit te vazhdueshem me mediat, sensibilizimi i opinionit publik eshte arrtituar edhe permes veprimtarive te tjera, qe gjate vitit 2003, e kane pasuruar pervojen e Keshillit te Ankesave me forma me te reja pune, si tryesa-debat “Per etiken ne median televizive” ne bashkepunim me Institutin Shqiptar te Medias (shkurt ‘03) dhe emisionin me specialiste e studente organizuar ne bashkepunim me TVA per transparencen e anketimit (dhjetor ‘03).

Pergjegjesia e operatoreve transmetues per te respektuar normat etike e morale ka ardhur duke u rritur, aq sa mund te thuhet se ne vitin 2003 ka patur nje ulje te ndjeshme te ankesave per skena te renduara erotike (gjate vitit 2003 nuk ka patur raste te filmave apo programeve pornografike) dhe me dhune, por eshte shfaqur nje fenomen i ri, ai i reklamave dhe i telefonatave me 0900, per te cilin kemi pasur ankesa edhe per mashtrim te teleshikuesve.

Ka ardhur koha e funksionimit te Kodeve te Etikes se çdo operatori, gje e cila do te ndikoje drejtperdrejt ne rritjen e pergjegjesise se tyre per respektimin gjithje e me te mire te normave etike e morale.

Sidoqofte, vihet re rritja e programeve te prodhua nga vete operatoret, madje dhe cilesore. Ka ardhur koha te organizohen edhe Festivale apo forma te tjera konkurrimi te prodhimeve te medias elektronike, ne gjurme te tradites se krijuar nga komuniteti i kineasteve. KKRT nxit forma te tilla shkembimi pervoje, por edhe te shperblimit special moral e material te arritjeve te spikatura, duke mbeshtetur financiarisht edhe shumen per çmimin e pare, b.f, por, sigurisht, per arsyet e pozicionit te vet ligjor, duke qendruar larg organizimit, jurive vleresuese, si dhe çdo procesi vleresimi apo vendimmarrjeje.

2. ADMINISTRIMI I FREKUENCAVE DHE TEKNOLOGJITE E REJA

Harta e Frekuencave, e realizuar ne fund te vitit 2002, i krijoj mundesine KKRT-se qe:

- **te percaktonte** mbulimin e çdo transmetuesi apo rrjeti transmetuesish;
- **te percaktonte** interferencat e demshme qe transmetuesit i shkaktojne reciprokisht njeri - tjetrit;
- **te percaktonte** dhe te **lokalizonte** te gjithe transmetuesit qe emetonin jashte zones se licensimit;
- **te percaktonte** transmetuesit qe mbulonin me te njejtin program te njejtin territor;
- **te percaktonte** frekuencat e lira ne pjesë te ndryshme te territorit te Shqiperise;

Sipas ketyre te dhenave, te cilat u perpunuan ne **data base-n** e Hartes se Frekuencave, u kriju mundesia qe KKRT:

- **te kordinote** kanalet e te gjitha stacioneve ekzistuese ne Shqiperi dhe me shtetet fqinje me te cilat kufizohet Shqiperia, per te shmangur interferencat;
- **te percaktoje** frekuencat e **lira te mbrojtura** per te siguruar zgjerimin e rrjeteve ekzistuese, apo per te krijuar rrjete te reja per mbulimin e territorit me sinjal;

Perpilimi i Hartes se Frekuencave i dha KKRT-se mundesine teknike per te mbajtur nen kontroll dhe per te regulluar gjendjen e frekuencave te emetuara ne territorin e Shqiperise. Harta perben instrumentin baze per Planin e Frekuencave Radiotelevizive per Shqiperine.

Gjate gjithe vitit 2003, eshte punuar intensivisht mbi Data Base-n e krijuar. Duke u thelluar ne te dhenat e mbledhura, me fokus kryesisht ne pjesen me problematike, perdomin e frekuencave televizive, gjendja e shfrytezimit te frekuencave ne territorin e Shqiperise paraqitet:

2.1. Mbulimi i Shqiperise me sinjale radio e televizive

Mbulimi me sinjal i territorit realizohet nepermjet pikave te transmetimit qe jane nyjet kryesore te rrjeteve te transmetimit.

Harta e Frekuencave identifikon gjithsej 55 pika transmetimi te shperndara ne territorin e Shqiperise, ku jane instaluar nje apo me shume pajisje transmetimi te operatoreve televizive vendore dhe kombetare, publike apo private. Prej tyre, ne 31 pika jane instaluar vetem nga 1 transmetues dhe ne 24 te tjera jane instaluar mbi nje transmetues.

Pikat individuale ndodhen kryesisht ne qytete dhe perdoren nga operatoret private vendore per mbulimin me sinjal te qytetit perkates. Zgjedhja e tyre eshte bere e diktuar kryesisht nga vendndodhja e studios. Ato nuk paraqesin interes, persa i perket ndertimit te rrjeteve rajonale dhe kombetare radio apo televizive.

Pikat e transmetimit me mbi nje transmetues jane te instaluara kryesisht ne lartesi te pershatshme per te siguruar mbulimin me sinjal te zonave me madhesi te konsiderueshme. Psh. pika transmetuese e instaluar ne malin e Dajtit mbalon krejt rajonin Durres - Tirane dhe nje pjesë te Ultesires Perendimore. Zgjedhja e pikave te transmetimit me mbi nje transmetues eshte bere kryesisht duke u bazuar ne studimet dhe eksperienca e RTSH dhe ndonjehere, edhe duke shfrytezuar infrastrukturen e tij. Per pasoje, prej

ketyre pikave sigurohet nje mbulim me cilesor i rajoneve te caktuara. Infrastruktura e ketyre pikave ne perjithesi eshte e kompletuar me kerkesat minimale (ambiente, kulla antenash, furnizimi me energji, etj). Studimi i ketyre pikave paraqet interes, pasi nje pjese e tyre mund te percaktohen si pika transmetimi edhe ne Planin e ardhshem te Frekuencave Radio e Televizive te Shqiperise. Nga 24 pikat e transmetimit te identikuara, llogaritet se mund te mbulohet afersisht 50 % e territorit te Shqiperise.

KKRT gjate vitit 2003 vazhdoi punen per identifikimin e pikave te tjera, te cilat se bashku me pikat e zgjedhura nga ekzistueset, do te perbejne teresine e pikave transmetuese te Planit Kombetar te Frekuencave, qe do te formojne rrjetin baze (primar) te transmetimit.

2.2. Shfrytezimi i frekuencave ne pikat e transmetimit

Secila nga pikat e transmetimit mbulon nje territor te caktuar te Shqiperise. Teresia e territoreve te tilla, perben zonen e mbulimit. Kombinimi i frekuencave te transmetuara prej ketyre pikave, lejon te krijohen rrjetet vendore, rajonale apo kombetare qe mbulojne me sinjal zona me madhesi nga nje rreth, deri ne gjithe territorin e vendit.

Okupimi i kanaleve ne menyre arbitrale dhe pa kriter ne secilen nga pikat, duke mos respektuar rekomandimet teknike, ka ngushtuar shfrytezimin e spektrit, nepermjet futjes se interferencave ne disa kanale, duke i kthyer ato ne te paperdorshme.

Nga studimi i te dhenave te Hartes se Frekuencave, rezultoi se gjendja e renduar ne cilesine e transmetimeve, ne pikat e perbashketa, ka ardhur kryesisht nga mosbatimi i Rec. ITU-R BT.1123 "Planning Methods for 625-line terrestrial television in VHF/UHF bands" ne te gjitha rastet e vrojtuara. Ne kete kontekst, gjendja paraqitet vecanerisht e renduar ne rajonin e Tiranes, ku eshte perqendruar numri me i madh i stacioneve transmetuese. Shmangjet kryesore, nga rekomandimi i permendor me siper, jane:

1. Okupimi i kanaleve ne menyre te njepasnjeshme, pa krijuar te pakten nje diferenca prej 1 kanali siç rekomandohet;
2. Mosrespektimi i mbrojtjes nga interferencat e shkaktuara prej oshilatorit lokal (kanali ($n+5$ per brezin UHF));
3. Mosrespektimi i mbrojtjes nga kanali pasqyror ($n+9$ per brezin UHF);
4. Perdorimi i fuqive te ndryshme te transmetuesve te vendosur ne nje pike;

Te dhena te hollesishme mbi sa u permend me siper, jepen ne anekset bashkengjitur, qe pasqyrojne okupimin e spektrit ne te gjitha pikat kryesore te transmetimit ne Shqiperi.

2.3. Shfrytezimi i frekuencave televizive ne zonen e Tirane

Te dhenat e Hartes se Frekuencave deshmuani se zona e Tiranes eshte zona me problematike, persa i perket shfrytezimit te frekuencave televizive dhe cilesise se transmetimit (shih Aneksin bashkengjitur). Aktualisht, ne piken e Dajtit (Fushe Dajt+Maje) jane ne transmetim 27 transmetues me fuqi prej 200 W deri ne 5 kW dhe ka presion per te shtuar edhe transmetues te tjere. Pika e Dajtit ka pamje vizive me disa pika te tjera transmetimi si Preza, Ardenica, Durresi, etj). Kjo do te thote qe frekuencat qe perdoren ne piken e Dajtit nuk mund te perdoren nga pikat e tjera ne rrethet Durres, Kavaje, Fushe Kruje, Lushnje, Fier dhe pjeserisht ne Lezhe e Berat. **Nje situate e tille ngushton ne maksimum mundesite per te operuar ne te gjithe zonen Tirane - Durres, deri ne Myzeqe.**

Per zonen e Tiranes, ishte prioritare marrja e masave urgjente per organizimin e Rregullimit te paraqitur ne Planin e Rregullimit dhe disiplinimit te fuqive te transmetimit, masa qe do te sillnin ne norme transmetimet ne kete pike.

Keto konkluzione ishin baza per marrjen e vendimit nr. 143, date 12.05.2003, "Per rregullimin e metejshem te transmetimeve radiotelevizive", per ndalimin e licencimit te transmetuesve te rind televizive analoge tokesore ne brezin UHF per mbulimin e rajonit te Tiranes, nga mali i Dajtit.

2.4. Shfrytezimi i frekuencave radio

Edhe ne shfrytezimin e frekuencave te brezit FM per transmetime radio jane konstatuar te njejtat defekte e probleme te evidentuara ne shfrytezimin e brezit te sherbimit televiziv. Edhe ne kete sektor, shumica e frekuencave u gjend e kapur arbitrarisht e pa kritere. Ktu gjendja paraqitet me e administrueshme, per shkak te disponueshmerise me te madhe te frekuencave. Por, nen dritten e kerkesave ne rritje, Departamenti Teknik ka bere kujdes qe te filloje riorganizimin edhe te frekuencave per sherbimin radio, duke percaktuar standardeet dhe normat e transmetimit dhe duke i respektuar ato ne te gjitha rastet e dhenies se frekuencave te reja.

2.5. Masat per permiresimin e shfrytezimit te frekuencave

2.5.1. Implementimi i Planit te Rregullimit

Per permiresimin e gjendjes si dhe per te rritur kapacitetin e spektrit te shfrytezuar, gjate vitit 2003 eshte punuar per sjelljen ne norme te perdonimit te frekuencave ne te gjitha pikat kryesore te transmetimit te identikuara. Kjo pune u konkretizua ne hartimin e Planit te Rregullimit te Frekuencave, i cili iu paraqit per diskutim e verejtje operatoreve ne seminarin e organizuar per kete qellim ne muajin shtator 2003.

Plani i Rregullimit, qe parashikon rregullimin e gjendjes ekzistuese te transmetimeve, duhet dalluar nga Plani Final i Rregullimit qe do te parashikoje masat per implementimin e Planit Kombetar te Frekuencave.

Objktivi i nje plani paraprak rregullimi eshte permiresimi i situates se renduar, sidomos ne "bottleneck", vendet e ngushtuara siç paraqitet rajoni i Tiranes. Ky plan rregullimi iu prezantua edhe operatoreve, ne seminarin qe u organizua ne muajin Shtator. Ne seminar operatoret u njohen me harten e frekuencave, konklusionet e saj dhe atje u shtrua domosdoshmeria e implementimit te planit te rregullimit, afatet dhe rregullat qe do ndiqeshin per zbatim. Eshte e domosdoshme te theksohet se bashkepunimi i operatoreve ne zbatimin e planit te rregullimit, eshte themelor ne realizimin e ndryshimeve rrenjesore ne cilesine e transmetimeve. Per fat te keq, ndonese seminari u prit mire nga operatoret dhe te pranishmit, asnje nga operatoret, pa perjashtim, nuk paraqiti asnje verejtje per propozimet konkrete te paraqitura. Bashkengjitur paraqiten materialet qe u paraqiten ne seminar, te cilat pasqyrojne si gjendjen ekzistuese, ashtu edhe ndryshimet e domosdoshme ne shperndarjen e frekuencave per te permiresuar si cilesine, ashtu edhe shfrytezimin e spektrit.

2.5.2. Dokumentimi dhe certifikimi i kanaleve te dhena per shfrytezim

Me qellim qe te mbeshtetet zbatimi i Planit te hartuar te Rregullimit, KKRT ka perqatitur dokumentacionin perkates, baza e te cilit perbehet nga **Leja per Perdorimin e Frekuencave radio apo televizive**. Pavaresisht nga fakti se te gjithe operatoret e licencuar nga KKRT kane ne perdorim nga nje numer te caktuar frekuencash te shperndara ne te gjithe territorin e Shqiperise, aktualisht, ata nuk disponojne Lejen per perdorimin e frekuencave, si nje dokument zyrtar qe i autorizon per te shfrytezuar ate frekuence mbi nje territor te percaktuar. Leja do te jepet vetem per kanalet apo frekuencat e caktuara nga **Plani i Rregullimit** i pershkruar me siper, pra do te jepet vetem per frekuencat e koordinuara e te mbrojtura nga interferencat. Ne Leje jane te pasqyruara te gjitha parametrat teknike te transmetimit, perfshire koordinatat e pikes se transmetimit, fuqine efektive te rrezatuar, zonen perkatese te mbulimit, normat teknike, detyrimet financiare, etj. Me zbatimin e Planit te Rregullimit, te planifikuar brenda 6-mujorit te pare 2004, KKRT do te pajise me lejen perkatese te gjitha frekuencat e dhena ne perdorim, te shoqeruara me targeten qe do t'i ngjitet çdo transmetuesi te licencuar.

2.5.3. Mbyllja e stacioneve qe mbulonin te njejtin territor me te njejtin program.

Me perfundimin e afatit te veprimit te ligjit nr. 8969, date 07.11.2002 "Per disa masa ne fushen e transmetimeve radiotelevizive", KKRT nderrmori masa per mbylljen e stacioneve te identikuara qe dublonin mbulimin e territorit, ne perputhje edhe me rekomandimet e OSBE-se. Kjo krijoji nje sasi te vogel kanalesh te lira.

2.5.4. Permiresimi i procedurave te licencimit, duke theksuar elementet konkurrues

Ndersa per operatoret e gjetur ne operim, KKRT ishte e ndergjegjishme se kerkesa e ligjit per konkurrim kandidaturash, gjate licencimit nuk mund te aplikohej plotesisht (konkretisht ato u aplikuan vetem gjate konkurrimit per operatore kombetare). Me stabilizimin e gjendjes dhe ligjerimin e operatoreve ekzistues, qe ngushtoi edhe spektrin e lire te frekuencave, aplikimi i plete i procedurave konkurruese u be domosdoshmeri. Eshte fakt se gjate vitit 2003 jane organizuar 5 konkurrime kandidaturash per licencimin e sherbimeve radio apo televizive vendore ne territore te caktuara, sipas disponibilitetit te frekuencave. Organizimi i konkurrimeve te tilla te kandidaturave u zhvillua sipas Rregullores "Mbi procedurat e licensimit te operatoreve private radio e televizive, miratuar me vendimin nr. 176, date 18.09.2003 te KKRT-se. Konkurrimi i kandidaturave ka ndihmuar ne permiresimin rrenjesor te dokumentacionit, si dhe ç'eshte me kryesoria, ne zgjedhjen e kandidaturave me te pershtatshme.

2.5.5. Ndalimi i leshimit te licencave per zonen e Tiranes

Deri sa te realizohet rialokimi i frekuencave ne baze te planit te rregullimit per Tiranen, ne kete zone eshte pezulluar leshimi i licencave te reja. Kjo tashme eshte sanksionuar me Vendimin e KKRT-se, nr.143, date 30.05.2003.

2.5.6. Zgjidhja e problemit te transmetimeve te palicencuara

Siq e tregoi Harta e Frekuencave, nje numer operatoresh, sidomos ata qe kane licence per te operuar mbi 4 prefektura, kane okupuar frekuencia jashte zones se tyre te licencimit. Deri me sot, ata nuk paguajne detyrime per mbulimin e zonave jashte zones se licencimit. Rekomandimi i Hartes se Frekuencave eshte qe te mbyllen transmetuesat, qe operojne pa nje licence te KKRT-se dhe perdorin frekuencia te pacaktuara nga KKRT-ja.

KKRT, e miraton kete qendrim, por, me perfundimin e afatit te veprimit te ligjit nr. 8969, date 07.11.2002, "Per disa masa ne fushen e transmetimeve radiotelevizive", Keshilli u ndodh perpara nje boshlleku ligjor qe konsistonte ne mungesen e percaktimit te operatoreve rajonale nga ligji ne fuqi "Per Radion dhe Televizionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise". Per te plotesuar kete boshlek, KKRT ka paraqitur projekt amendimin, qe do te lejonte krijimin e kesaj kategorie operatoresh.

Nje nderprerje drastike, menjehere pas perfundimit te veprimit te ligjit, do te shkaktonte pa dyshim reaksion te forte mediatik nga operatoret per cenim te investimeve te tyre. Nje zgjidhje per problemin e krijuar eshte dhene ne takimin e organizuar ne Kopenhage midis perfaquesuesve te KKRT-se dhe ERO-s. **Zgjidhja konsiston ne pajisjen e operatoreve qe operojne jashte zones se licencimit, me licenca provizore per zonat ne fjale.** Periudha e licencimit per keto zona mund te jete 1 vit apo deri ne fund te periudhes se licencimit te operatoreve vendore. Duke konsideruar se shumica e operatoreve jane licencuar ne fillim te vitiit 2001 dhe koha e licencimit per keta lloj operatoresh eshte 5 vjet, licenca provizore mund te kete kohezgjatje maksimale deri ne 1 vit.

Per te realizuar licencimin provizor, kerkohet nje nderhyrje **urgjente** ligjore, me ane te nje amendamenti te ligjit me veprim te perkohshem, siç u veprua edhe ne rastin e amendimit paraardhes. Ne baze te amendimit te ri, **licence provizore do te perfitojne ata transmetues qe nuk shkaktojne interference tek transmetuesit e operatoreve te licencuar dhe qe pranojne te zbatojne planin e rregullimit dhe rregullat e KKRT-se.**

Keta operatore do t'i nenshtrohen gares per licence kombetare ose rajonale; te skualifikuarit do te jene te detyruar t'i mbyllin keto impiante.

Ne kete menyre do te legalizohen te gjithe transmetuesit televizive ne territorin e Shqiperise, duke ulur edhe presionet nga disa operatore per t'u shpallur si operatore kombetare.

Propozimet e mesiperme i jane bere te njohura edhe Komisionit Parlamentar te Mjeteve te Informimit Publik me letren tone nr. 591, te dates 01.09.2003.

2.5.7. Organizimi i gares per nje rrjet tjeter privat kombetar.

Teknikisht, eshte e mundur te organizohet nje gare per krijimin e nje rrjeti tjeter privat kombetar. Departamenti Teknik ka percaktuar pjesen me te madhe te frekuencave te nevojshme per krijimin e segmentit primar te ketij rrjeti te ri. KKRT mendon te shpallo kriteret dhe te organizoje konkurrimin e kandidaturave per nje licence gjate vitiit 2004, duke e prezantuar projektin ne **Konferencen e Dyte Kombetare te Mediave Elektronike.**

2.5.8. Rinnovimi i licencave qe perfunduan ne fund te vitiit 2003.

Ne fund te vitiit 2003 perfundoi periudha e licencimit per nje numer te konsiderueshem operatoresh radio FM vendore. (Sipas ligjit, kohezgjatja e licencave radio FM vendore eshte 3 vjet). **KKRT percatiti dhe shpalli kriteret e reja te licencimit te ketyre operatoreve brenda muajit Korrik 2003.** Kriteret e reja te vleresimit perfshire dhe pika te veçanta qe merrnin parasysh edhe sjelljen e operatorit gjate periudhes se meparshme te licencimit, si zbatimin e planit te investimeve, realizimin e mbulimit te zones se licencimit, respektimin e kushteve te licences, te te drejtave te

autorit, detyrimin per ndryshimin e frekuencave, realizimin e pagesave e te taksave, paraqitjen e bilancit vjetor, etj etj.

Paketa e gares se re kishte pra, nje numer elementesh te rrinj. Po keshtu edhe sistemi i vleresimit te operatoreve.

Si rezultat i punes intensive, u arrit qe brenda afateve ligjore te rilicencoheshin 16 operatore radio (+1 tv) vendore. Nderkaq, 1 operator nuk plotesoi kushtet per rilicensim, kurse 2 nuk paraqiten interes per t'u rilicensuar.

Procesi i rilicensimit u shfrytezua per te marre masa per nje administrim me te mire te frekuencave te brezit FM, si dhe per te rregulluar ne bashkepunim me ERT-ne, perdonimin e frekuencave per sherbimet fikse te operatoreve radio FM (r/rele), qe administrohen nga Enti. Ne kete kuader, nuk u rilicensua asnje operator radio, i cili nuk kishte marre lejen per perdonimin e frekuencave r.rele nga ERT.

Organizimi i konkurrimit dhe dhenies se licencave per operatoret radio FM vendore sherbeu si nje eksperience dhe prove per rinoimin e licencave per operatoret televizive, qe duhet te realizohet gjate vitit 2005. Pergatitjet per kete konkurrim do te fillojne qysh ne vitin 2004.

2.5.9. Licensimi i operatoreve TV vendore te vegjel ne zonat e largeta

Masat nxiteze per mbulimin e zonave me popullsi te rralle

Rezultatet paraprake te studimit te Hartes se Frekuencave deshmojne se akoma ekzistojne disa zona, sidomos ato te largeta dhe te pjeses Verilindore te Shqiperise, ku spektri ka rezerva te pashfrytezuara, ne nje kohe kur nuk mungojne keresat per licencimin e operatoreve te vegjel, qe do te operojne ne zona te kufizuara, qe mund te mbulohen nga lartesi jo te medha dhe me fuqi te vogla transmetimi. KKRT do te vazhdoje licencimin e operatoreve te tille qe do t'u sherbejne nevojave per informacion e argetim te komuniteteve vendore. Keto nevoja do te plotesohen edhe nepermjet licencimit te ritransmetimit te programeve te huaja me perserites (me fuqi te vogla dhe ne lartesi jo te medha), te zgjedhur sipas kritereve te percaktuara. Si nje shembull i mire bashkepunimi me komunitetin lokal mund te sherbeje zgjidhja teknike qe u dha ne fund te vitit 2003 per mbulimin e rajonit te Priskes se Vogel, qe ndonese ndodhet prane Tiranes, nuk mbulohej nga asnje sinjal televiziv.

2.5.10. Perfundimi i Planit te Frekuencave

Tashme eshte me se e vertetuar qe hartimi i Planit Kombetar te Frekuencave Radiotelevizive, eshte nje domosdoshmeri. Perfundimi i Hartes se Frekuencave perben bazen per hartimin e Planit. Plani i Frekuencave, se bashku me strategjine e zhvillimit te transmetimeve radio e televizive, do te percaktojne objektivat e saktave dhe do t'i hapin rruge zhvillimit te studiuar dhe racional te ketij sektori te rendesishem, jo vetem ekonomik te vendit. Ne kete drejtim:

a) KKRT ka pergatitur dhe miratuar me Vendimin nr. 140, date 30.04.2003, kriteret per hartimin e Planit te Frekuencave Radiotelevizive.

b) Ne bashkepunim me ERO (European Radiocommunications Office), jane pergatitur Termat e References se gares per percaktimin e konsulentit nderkombetar qe do te mbeshtese KKRT-ne, ne hartimin e dokumentit te strategjise se zhvillimit dhe planit te frekuencave.

c) Eshte hartuar nje projekt i kerkeses per percaktimin e konsulentit nderkombetar per hartimin e dokumentit te strategjise se Zhvillimit te Ttransmetimeve Radio e Televizive ne Shqiperi, i cili u eshte derguar per mendime, verejtje e sugjerime disa institucioneve qendrore te vendit e te huaja. Ne perjigje te kerkeses sone, jane treguar te gatshem, jo vetem te japid sugjerime, por edhe te marrin pjese ne komisionin e vleresimit dhe ne hartimin e vete dokumentit te strategjise, Zyra e Prezences se OSBE-se ne Tirane, etj. Pritet perjigje nga Ministria e Ekonomise.

d) Po merren masa per te filluar qysh ne fillim te vitit 2004, procedurat e hapjes se tenderit per percaktimin e firmes konsulente ne perqatitjen e Strategjise se Zhvillimit dhe Planit Kombetar te Frekuencave.

2.5.11. Pergatitja e amendimeve te nevojshme ligjore

Perfundimi i dokumentit te politikes dhe strategjise se zhvillimit te transmetimeve radio e televizive ne Shqiperi, do te percaktoje objektivat afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate te sektorit. Disa prej ketyre objektivave paraprakisht po marrin forme qysh sot, nepermjet rekomandimeve te organizmave nderkombetare. Per arritjen e ketyre objektivave, do te kerkohen permiresime te ligjit ekzistues. Pergatitja e permiresimeve te nevojshme do te realizohet nga fundi i vitit, me perfundimin dhe miratimin e dokumentit te politikes se zhvillimit. Kjo periudhe perkon ne kohe me perqatitjet per rinovimin e licencave te shumices se operatoreve vendore televizive, gje qe krijon mundesi per venien e menjehershme ne funksionim te dispozitave te amendoara te ligjit, duke dhene efekt te drejtperdrejte ne permiresimin e cilesise dhe forcimin e rregullit dhe zbatimit te ligjit ne transmetimet radio dhe televizive.

Paraprakisht, ne raportin e Hartes se Frekuencave kerkohet:

Reduktimi i zones se licensimit per licensat vendore deri ne 1 prefekturë.

Aktualisht, jane licencuar 13 operatore me shtrirje deri ne 4 prefektura. Mbulimi i nje zone te tille relativisht te gjere, kerkon projektimin e **nje rrjeti** transmetuesish, realizimi i te cilit do te kerkonte nje pakete frekuencash. Ridimensionimi i zones se licencimit per operatoret vendore synon pikerisht te redukoje frekuencat qe do te perdoren nga operatoret e vegjel vendore, per te krijuar hapesirene e nevojshme per operatoret rajonale e kombetare. Nga ana tjeter, perderisa keta operatore disponojne nje licence te leshuar nga nje organ i autorizuar, dhe i perqiegjishem, reduktimi i licences se tyre nuk mund te behet menjehere, qofte edhe me amendimin e ligjit, pasi kjo do te rrezikonte investimet e ligjshme te realizuara per zgjerimin e rrjetit. Prandaj, per venien ne jete te amendimit, KKRT propozon qe te shfrytezohet periudha e rinovimit te licencave, ne perfundim te afatit te licencimit. Gjate vleresimit te aplikimeve per rinovimin e licences, KKRT do te kualifikoje vetem ato subjekte qe kane qene rigorozë ne zbatimin e kushteve te licences aktuale, si zbatimi i te drejtave te transmetimit dhe pronesise intelektuale, realizimi i mbulimit, etj. Subjektet qe nuk do t'i plotesojne kushtet do te kthehen ne vendore me shtrirje deri ne 1 prefekturë. Kjo nuk perjashton mundesine qe, per subjektet vecanerisht te parregullt, ne zbatimin e ligjit dhe kushteve te licences, licenca nuk do te rinovohet. Nje gje e tille do te sjelle edhe realizimin e objektivit te dyte te percaktuar ne rekomandimin e Hartes se Frekuencave, qe eshte:

Kufizimi i numrit te licencave vendore, qe i sherben krijimit te spektrit te lire per licenca rajonale dhe kombetare

Ketij qellimi i sherben edhe miratimi i kritereve per hartimin e Planit Kombetar te Frekuencave Radiotelevizive qe percaktojne raportin 30 % me 70 % midis frekuencave te perdonura per licenca vendore dhe atyre te perdonura per licenca rajonale e kombetare. (Shih kriteret bashkengjitur).

2.5.12. Transmetimet satelitore

Viti 2003 shenoi futjen ne funksionim te operatorit te pare shqiptar te transmetimeve me satelit ALSAT. Realizimi i nje iniciative te tille te guximshme, eshte pa dyshim nje arrite ne rrugen e rritjes se diversitetit teknologjik qe i jep perdonuesit me shume mundesi zgjedhjeje. Rregullimi i kesaj veprimtarie te re, pati problemet dhe veshtiresite e veta qe linden kryesish nga mosnjohja e ligjit nga operatori satelitor dhe precedentet e krijuar ne zbatimin e tij, nga operatoret e tjere te licencuar ne transmetime analoge tokesore. Menjehere pas stabilizimit te transmetimeve dhe fitimit te nje reputacioni fillestar si operator serioz dhe cilesor, filluan pretendimet e ALSAT per te ndertuar nje rrjet transmetimi analog tokesor per te mbuluar pjese te konsiderueshme te territorit shqiptar. Nje praktike e tille, sidoqofte, nuk ishte e parashikuar nga ligji "Per Radion dhe Televisionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise". Pavaresisht nga mungesa e referencave te nje praktike te tille, me arsyetimin se perdonuesi shqiptar akoma nuk i perballon shpenzimet per te siguruar marresin satelitor, ne muajin Korrik, me ane te ligjit ligjt nr. 9124, date 29.07.2003. "Per disa shtesa ne ligjin nr. 8410, date 3.09.1998, per Radion dhe Televisionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise", u realizua amendimi i meposhtem, i cili percakton (Neni 136/1):

"Operatoret radiotelevizive te licencuar nga KKRT-ja per perhapjen e programeve radiotelevizive ne rrjet tokesor kane te drejte te ritransmetojne programet e tyre edhe ne rrjetin satelitor. Operatoret radiotelevizive te licencuar nga KKRT-ja per perhapjen e programeve radiotelevizive ne satelit kane te drejte te ritransmetojne programet e tyre edhe ne rruge tokesore. KKRT percakton kushtet perkatese ne perputhje me kete ligj".

Ne mbeshtetje te ketij amendamenti, KKRT, pas diskutimit me te interesuarit e shoqatat e operatoreve, me vendimin nr. 175, date 18.09.2003, miratoi Rregulloren "Per ritransmetimet e programeve radiotelevizive tokesore me satelit dhe ndersjelltas". Rregullorja percakton kushtet dhe menyrat e ofrimit te sherbimit alternativ, si nga operatoret e licencuar per transmetime tokesore analoge, ashtu edhe nga operatoret e licencuar per transmetime satelitore. Rregullorja bazohet ne konceptin e meposhtem: Operatoret e **licencuar** per transmetime me satelit **kane te drejte** te ritransmetojne programet ne rruge tokesore dhe ndersjelltas, operatoret e **licencuar** si operatore per transmetime ne rrjet tokesor **kane te drejte te ritransmetojne programet e tyre edhe ne rrjetin satelitor**. Te drejtat e ndersjellta sigurohen nepermjet **lejeve** te percaktuara ne rregullore. Ne kete menyre, ai qe zoteron nje **licence baze** per nje lloj transmetimi, sipas kerkeses, mund te pajiset me **leje** per nje transmetim alternativ. Keshtu respektohet edhe pengesa e drejte e vendosur nga neni 20 e ligjt 8410: "Nje person fizik ose juridik, qe ka aksione ne nje shoqeri televizive ose radioje kombetare, nuk lejohet te jete, drejperdrejt apo terthorazi, pjesemarres ne nje shoqeri te dyte televizive ose radioje kombetare, si dhe nuk i lejohet te marre licence per transmetim televiziv ose radioje vendore".

Eshte me se e kuptueshme qe leja per nje transmetim alternativ nuk mund te jepet po qe se nuk ekziston licenca per transmetimin baze. Prej ketij percaktimi burojne edhe

kufizimet e lejes. P.sh. leja per ritransmetime ne satelit te operatoreve qe zoterojne licence per transmetime tokesore (kombetare apo vendore) eshte e kufizuar ne faktin se ata mund te ritransmetojne vetem programin e tyre, ndersa operatoret e licencuar per transmetime ne satelit mund te transmetojne po me satelit nje numer te pakufizuar programesh, duke shfrytezuar edhe resurset relativisht te medha te spektrit te radiofrekuencave satelitore. Nga ana tjeter, leja per ritransmetime ne rrjet tokesor per operatoret e licencuar per transmetime me satelit eshte e kufizuar, pasi ata mund te ritransmetojne ne rruge tokesore **vetem nje program dhe vetem ne zonat ku ekzistojne frekuanca te lira.** Ne kete kuptim, leja per ritransmetime tokesore nuk presupozon shtremberimin e tregut te vendosur te transmetimeve tokesore ne favor te operatorit satelitor, apo konkurrence te pandershme kundrejt operatoreve te licencuar per transmetime tokesore, kombetare ose lokale, te cilet e kane fituar licencen pas konkurrimit te kandidaturave. Duke patur parasysh sa u trajtua me siper, KKRT ka bere kujdes qe leja per ritransmetime tokesore te operatorit satelitor te mos tejkaloje qellimin e saj per lehtesimin e kapjes se programeve satelitore nga popullsia, sidomos ajo e zonave te largeta e te varfera, pasi, nuk duhet harruar, se as ligji e as rregullorja nuk e ndalin instalimin e marresave satelitore **ne te gjithe territorin e vendit.** Ne perputhje edhe me eksperiencen e vendeve te tjera, me rritjen e nivelit te jeteses, duke u rritur numri i marresave satelitore ne vend, do te vije duke u ulur edhe kerkesa per ritransmetimin e programeve satelitore ne rruge tokesore.

Ne kundershtim me ligjin dhe rregulloren e mesiperme, ALSAT, pa aplikuar per leje per transmetime tokesore hyri ne nje marreveshje te pamiratuar ne KKRT, (kerkese e ligjit), me operatorin TV ALBA per te perdonur valet e ketij te fundit per te transmetuar ekskluzivisht programet e veta 24 ore ne 24.

Kjo shkelje perbente nje precedent te trezikshem te akaparimit te frekuencave nga disa operatore te fuqishem qe do te conte ne monopolizim te tregut dhe sidoqofte, KKRT, per shkelje te vazhdueshme te kushteve te licences, i hoqi te drejten e transmetimit ALBA TV, tashme te falimentuar, me ambiente te dyllosura me vendim gjykate, per shkak te borxheve te papaguara, etj.

Eshte per t'u permendur se qendrimi i mbajtur ne fushaten mediatike, propagandistike kunder KKRT-se e te ashtuquajturate çeshje Alba TV – ALSAT, ne rastin e zbatimit te vendimit te permendur me siper, nuk ndikoi ne sjelljen standarde te KKRT-se pas paraqites nga ALSAT te kerkeses per leje per riperseritjen e programit te tij ne rruge tokesore. Me kete rast, nga KKRT u moren te gjitha masat per miratimin sa me te shpejte te lejes dhe per fillimin pa vonese te transmetimeve tokesore, ne perputhje me ligjin, rregulloren, dhe mbi te gjitha, pa diskriminuar operatoret e licencuar ne baze te konkurrimit te kandidaturave. Aktualisht, ALSAT transmeton nga Fushe-Dajti ne kanalin E7 VHF dhe mbulon rajonin Tirane-Durres. Nga ana e KKRT-se i jane propozuar edhe pika te tjera per instalimin e transmetuesve me fuqi te vogel dhe ne lartesi te vogla per te mbuluar disa qytete kryesore.

Kohet e fundit kane ritransmetim satelitor, qofte edhe ne forme eksperimentale, TV KLAN, Televizioni TOP CHANNEL, Shijak TV e ndonje tjeter. Ndonesi KKRT tashme ka pergatitur kuadrin rregulator dhe procedurat per disiplinimin e kesaj veprimtarie, ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per Radion dhe Televizionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise", hartimi i te cilit eshte konsultuar edhe me shoqatat e operatoreve, asnjeri nga operatoret e permendur nuk ka paraqitur dokumentacionin per

marrjen e lejes se transmetimit. Duke i mbetur besnik parimit, tashme te provuar te nxitjes se zhvillimit te sektorit dhe jo te pengimit, KKRT njekohesisht ka insistuar per sjelljen ne norme dhe disiplinimin e ketyre bizneseve nepermjet pajisjes se tyre me lejen operative perkatese. Per kete eshte planifikuar qe procesi i pajisjes me leje te ketyre operatoreve te perfundoje brenda tremujorit te pare 2004.

Operatoret Ca-TV

Tashme ne vend operojne 9 operatore te licencuar te transmetimeve televizive me kabell. Disa prej tyre kane qene ne funksionim perpara krijimit te KKRT-se. Ne ndryshim me operatoret qe transmetojne ne efir, operatoret televizive me kabell ofrojne sherbimin ne baze te kontratave individuale me abonentet, duke shtrire linjat kabllore deri ne banesat e ketyre te fundit. Perveç licences nga KKRT, perpara fillimit te operimit, keta operatore duhet te pajisen nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT) me Leje, qe ka te beje me respektimin e kushteve teknike te shtrirjes se kabllit ne zonat e banuara. Duke qene se nuk perdorin breza frekuencash ne efir, licencimi i tyre nuk eshte i kufizuar. Te gjithe operatoret TV me kabell ne funksionim, perdorin transmetimet analoge ne brezin S te mbeshtetur ne kabllo koaksiale, qe u lejon te transmetojne 20-40 kanale deri tek perdoruesi. Ne per gjithesi keta operatore nuk kane sisteme te administrimit te abonenteve.

Gjate ketij viti KKRT ka punuar me ERT per percaktimin e procedurave per leshimin e Lejes ne fjale. Mbikqyrja e veprimtarise se operatoreve televizive me kabell eshte realizuar mbi te njejtat kriterie, si edhe per operatoret e tjere.

Deri perpara miratimit te ligjit nr. 9124, date 29.07.2003, "Per disa shtesa ne ligjin nr. 8410, date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televisionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar", te gjithe operatoret ndodheshin ne te njejtat kushte, per sa i takon zbatimit te te drejtave te autorit etj. Pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji, ndersa gjendja e operatoreve, qe transmetojne ne efir dhe qe monitorohet nga KKRT, ndryshoi rrenjesisht, gjendja e operatoreve TV me kabell nuk ka ndryshuar shume. Ne kete kategori operatoresh ka akoma te tille qe transmetojne programe pa patur kontrate me pronaret e ketyre programeve, duke u bere konkurrence te pandershme operatoreve qe zbatojn ligjin. Nga KKRT po merren te gjitha masat per nderprerjen e menjehershme te veprimtarise se paligjshme.

Theksojme se pas hyrjes ne fuqi te ligjit te permendor me siper, eshte rritur interesi per ndertimin e rrjeteve kabllore per transmetime TV, madje ne ndonje rast, si ne Elbasan, Kuçove etj, disa persona kane filluar operimin pa marre asnje licence apo leje, si nga KKRT ashtu edhe nga ERT, duke perfituar edhe nga veshtiresite qe ka KKRT per identifikimin e tyre, meqe ata nuk emetojne sinjale ne efir. Duke qene se per ndertimin e rrjetit, keta lloj operatoresh shtrijne linjat kabllore neper qendra te banuara, nje ndihme per lokalizimin e identifikimin e tyre mund te jepin pushteti lokal dhe organet tatimore lokale. Per kete, nga ana jone u jemi drejtuar ketyre organeve, duke u kerkuar bashkepunim.

Per vitin ne vazhdim mbetet detyre paresore e KKRT-se thellimi i masave per mbikqyrjen e monitorimin e veprimtarise se operatoreve radiotelevizive me kabell.

2.5.13. Transmetimet dixhitale dhe teknologjite alternative

2.5.13.1. Veshtrim i per gjithshem

Zhvillimi i televizionit digital paraqet nje moment te rendesishem per te gjithe industrine audiovizuale (transmetuesit, producentet, organet rregullatore), pasi ai po shkakton ndryshime te shpejta ne strukturen strategjike dhe ekonomike te sektorit.

Me poshte jepen aspektet kryesore te ndryshimeve:

- Nga pikepamja ekonomike: rritja e konkurrences, zhvillim i shpejte i formave te financimit, probleme te hyrjes ne treg, rritja e te ardhurave nga pajtimet, zhvillimi i industrise se programeve, mbrojtja e te drejtave ekonomike te producenteve, etj.
- Nga pikpamja politike e legislative: zhvillimi i rolit rregulator te autoriteteve publike, harmonizimi i legjislacionit kombtar, niveli operativ, problemi i perqendrimit ne kundershtim me pluralizmin, ndryshimi i marredhenieve midis sektoreve lokale, rajonale, kombetare dhe nderkombetare, roli i transmetimeve publike, etj.
- Nga pikepamja kulturore: rritja e komercializimit te sektorit, zhvillimi i nje krijimtarie unike panEuropeane e boterore, mbrojtja e te drejtave morale te krijuesve, etj.
- Nga pikepamja nderkombetare: krijimi i nje kuadri nderkombetar per tregtine audiovizuale, disbalancimet tregtare.

Nga futja e televizionit digital, do te perfitojne telespektatoret te cilet do te kene ne dispozicion nje numer me te madh kanalesh per te zgjedhur, sherbime te reja (pay-per-view, near-video-on-demand, guida elektronike programesh, akses ne internet, etj.), cilesi me te mire te figures, etj. Kjo zgjedhje me e madhe do te fuse nje barre suplementare kostoje mbi konsumatoret. Ata duhet te blejne pajisje te reja, duhet te pajtohen ne rrjetet, etj. Futja e televizionit digital mund te zgjeroje diferenca midis atyre qe mund te perballojne ekonomikisht pagesat e rritura per te patur akses ne informacion dhe kulture dhe te atyre qe nuk mund ta perballojne kete.

Teknologja e re do te fragmentoje audiencen dhe permes ketij fragmentimi do te ndikoje edhe ne shoqeri.

2.5.13.2. Zhvillimet e televizionit digital ne vendet e Evropes Perendimore

Frekuencat tokesore: Faza DSI II dhe marreveshja e Cesterit (1997)

Nje nga avantazhet kryesore te televizionit digital eshte racionalizimi i perdonimit te spektrit te radiofrekuencave.

Ngritura e rrjeteve te televizionit digital, nepermjet satelitit, kabllit apo rrjeteve tokesore perfshihet ne qellimin e politikes europiane te telekomunikacioneve dhe per pasoje eshte dashur nje pune e konsiderueshme per peraktimin strategjik dhe planifikimin nga shume organe perjegjese per administrimin e spektrit (ITU, CEPT), peraktimin e parimeve per nje politike Europiane te telekomunikacioneve (Bashkimi European), zhvillimi strategjik te rrjeteve te reja (operatoret satelitore, kabllore dhe te rrjeteve tokesore).

Sipas te dhenave nga Raporti "Zhvillime ne televizionin digital ne Bashkimin European" (Developments in digital television in the European Union" i hartuar nga Dr.André Lange, Expert (Market Information) ne EUROPEAN AUDIOVISUAL OBSERVATORY), Zyra Europeane e Radiokomunikacioneve (The European

Radiocommunications Office-ERO), qe eshte zyra e perhershme e Konferences Evropiane te radiokomunikacioneve (CEPT-ERC), me 43 Shtetet Anetare, ndermori nje studim ekstensiv mbi brezat e frekuencave midis 29.7 dhe 960 MHz. Studimi perfundoi ne Mars 1996 dhe dha nje seri rekomandimesh si dhe beri thirrje per komente. Keto pershkruhen ne materialin “*Resultate te Investigimit te Detajuar te Spektrit dhe fteze per komente*” (*Results of Detailed Spectrum Investigation – DSI Phase II: 29,7-960 Mhz and Call for Comments.*)

Rekomandimi 13 i ketij materiali paraqiti afatet e meposhtme per kalimin ne digital:

- 1997: miratimi i parametrave planifikues
- Fillim 1998: Mbledhje e CEPT per te planifikuar futjen e televizionit digital
- Fundi i 1998: Futja e televizionit digital
- Konference e ITU-UIT:
 - per te perpunuar kerkesat teknike per televizionin digital
 - per te rishikuar Marreveshjen e Stockholmit 1961
 - per te planifikuar perfundimin e televizionit analog
- Prej 2008 e me tej: mbyllja e televizionit analog
- Prej 2020 e me tej: rishikimi i perdonimit te brezit 174-216 MHz dhe mundesisht e brezit 470-510 MHz per sherbime te tjera.

Televizioni digital tokesor filloi ne Mbreterine e Bashkuar ne Tetor 1998 dhe ne Suedi ne fillim te vitit 1999. Ne Spanje, ne Qershori 1999 dhe ne Finlande u akorduan licencat e para per ndertimin e rrjeteve televizive digitale. Disa shtete qysh me 1999 kishin fiksuar tashme (shpesh ne nje menyre indikative) daten e mbylljes se transmetimeve analoge tokesore:

- Gjermania: 2010 (parashikuar rishikimi ne 2003). Ne vitin 2003 eshte dhene njoftimi mbi mbulimin me sinjal televiziv digital tokesor te Berlinit.
- Spanja: 2010
- France: 2010
- Itali: 2010 (Tashme, me ligjin e ri Gaspari qe pritet te hyje ne fuqi shume shpejt, kjo date eshte afruar per ne fillim te vitit 2007. Per futjen e transmetimeve tv digitale ne kete vend parashikohen edhe masa nxiteze e subvencione qeveritare. Nderkohe, kane filluar me intensitet ne rritje, transmetimet eksperimentale digitale)
- Holanda: 2010 (ne shqyrtim)
- Suedi: 2010

Autoritetet e Telekomunikacioneve te CEPT-it u takuan ne Cester (Chester) ne Korrik 1997 ne nje mbledhje te jashtezakonshme te grupit FM per te diskutuar dhe vendosur kriteret teknike, parimet e koordinimit dhe procedurat per futjen e transmetimeve tokesore digitale (TNT). Mbledhja u pasua nga nje mbledhje e autoriteteteve rregullatore qe nenshkruan nje marreveshje multilaterale, bazuar ne punen e grupit FM (CEPT, *The Chester 1997 Multilateral Co-ordination Agreement relating to technical Criteria, Coordination Principles and procedures for the introduction of Terrestrial Digital Video Broadcasting (DVBT)*, Chester, 25 July 1997). Kjo marrveshje vendosi :

- Brezat e frekuencave

- Kriteret teknike per t'u perdorur per futjen e DVB-T
- Kushtet e perpuethshmerise me sherbimet e tjera te radiokomunikacioneve
- Rregullat e procedures per koordinimin dhe analizen e perpuethshmerise, strukturen e regjistrit, etj.

2.5.13.3. Impakti i zhvillimeve te televizionit digital ne kuadrin ligjor kombetar per radion dhe televizionin.

Ne vazhdim te protokollit te Traktatit te Amsterdemit (nenshkruar nga vendet e BE) duket se do te pranohet qe shtetet do te mbeten perqejges per vendimet lidhur me financimin e sherbimit publik, por ne te njejtën kohe Komisioni Evropian po u kerkon shteteve te percaktojne konceptin e sherbimit publik, me qellim qe te percaktohen fushat e konkurrences.

Lidhur me te ardhmen e sherbimit publik, nen driten e zhvillimeve te televizionit digital, lindin nje sere pyetjesh, qe duhet te zgjidhen. Ne dokumentin e Strategjisë se Zhvillimit, te planifikuar te perqatitet gjate ketij viti, nje vend te rendesishem do t'i kushtohet dhenies perqigje ne menyre sa me konsensuale e te plote te pyetjeve si:

- Cfare implikimesh do te sjelle logjika e dallimit te veprimtarive te operatoreve te sherbimit publik ne zhvillimin e sherbimeve te reja ne mjedisin digital?
- A do te vazhdoje te sigurohet shperndarja e kanaleve publike nepermjet principeve te percaktuara ne rregullore?
- Si do te sigurohet financimi i sherbimit publik me qellim qe te ruhet dhe zhvillohet misioni i tij ne epoken digitale? A eshte zgjidhje parimi i propozuar nga Britania e Madhe per nje pagese mujore “digitale” qe do te paguhet vetem nga individet qe perdonin sherbimet digitale te ofruara nga sektori publik?

Pyetje te tjera qe shtrohen lidhur me kanalet dhe sherbimet private:

- Multiplikimi i kanaleve, veçanerisht kanaleve satelitore, e ben te vjeteruar argumentin se spektri eshte i kufizuar. Ky ka qene njeri prej argumenteve historike i cili ka justifikuar sistemin e leshimit te licencave. Sidoqoftë a eshte e nevojshme te parashikohet zhdukja e sistemeve te autorizimit duke e lene televizionin te trajtohet si sherbim qe eshte subject vetem i inisiatives se lire te operatoreve, si interneti? Apo, perkundrazi do te vazhdojme ta konsiderojme spektrin akoma si burim te kufizuar dhe te adaptojme menyrat e dhenies se licencave duke perdorur teknikat e ankandit te cilat tashme jane futur ne disa vende?

2.5.13.4. Planifikimi i TV digital ne Shqiperi

Kete vit kemi ndjekur me kujdes zhvillimet e kesaj teknologjie ne Evrope dhe ne bote.

Tashme, eshte perforuar bindja se duke bere pjese ne kontinentin Evropian, Shqiperia nuk mund t'i shmanget zhvillimit teknologjik. Subjekte qe deri nje vit me pare e mendonin futjen e televizionit digital ne Shqiperi si fantazi, tashme kane opinionin se jemi te vonuar ne planifikimin e masave. Ne te vertete, si rezultat i zhvillimit teknologjik, me mbylljen e sherbimit analog, industria Evropiane nuk do te prodroje me pajisje, sidomos marresa analoge. Shqiperia do te detyrohet te aplikoje edhe ajo kalimin gradual ne teknologjine digitale. Prandaj KKRT eshte e mendimit se jemi ne kohen e duhur per te

planifikuar masat dhe per te perqatitur kushtet per fillimin e eksperimentimit te rrjeteve te para digitale.

Eshte fakt se nga operatore dhe persona te vecante ka filluar interesimi per futjen e kesaj teknologje edhe ne vendin tone. Nga KKRT po merren masa per kanalizimin e ketij interesimi ne favor te zhvillimit te harmonizuar, per te mos krijuar probleme me vone. Per kete qellim, eshte vendosur qe krahas Planit te Frekuencave Analoge Tokesore qe u permend me siper, te zhvillohet edhe Plani i Frekuencave Digitale Tokesore, duke shfrytezuar **te njejtat pika transmetuese**, mbeshtetur edhe ne eksperienca italiane, qe patem rastin ta studiojme gjate nje vizite prane organit rregulator Italian AGCOM te zhvilluar gjate muajit Korrik 2003.

Bazuar ne punen perqatitore te zhvilluar dhe qe do te zhvillohet gjate vitit 2003, brenda ketij viti, KKRT mund te jete ne gjendje te autorizoje lejet e para eksperimentale televizive digitale tokesore.

Gjithashtu po punohet per nxitjen edhe aplikimin e teknologjive te tjera alternative si TV me kabllo, MMDS qe bazohet ne transmetimet e te dhenave me bande te gjere. Mendojme se keto masa do te krijojne mundesi e hapesira te reja per operatoret e mediave elektronike.

2.5.14. Monitorimi i frekuencave dhe mbajtja e regjimit te vendosur

Administrimi i spektrit eshte nje kombinim i procedurave administrative, shkencore dhe teknike, i nevojshem per te siguruar nje operim efikas te pajisjeve dhe sherbimeve te radiokomunikacioneve pa shkaktuar interference te demshme. Qellimi i administrimit te spektrit eshte te maksimizoje efikasitetin e spektrit dhe te minimizoje interferencat. **Harta e Frekuencave** (ne mungese te Planit) ku eshte fiksuar gjendja dhe **te dhenat e monitorimit periodik**, perbejne dy instrumente baze per te mbajtur regjin e vendosur ne shfrytezimin e frekuencave. Krahasimi i te dhenave te Hartes se Frekuences me te dhenat e monitorimit, te zhvilluar periodikisht nga KKRT ka vertetuar se gjate periudhes pas dhjetorit 2002 e ne vazhdim, duke mos respektuar ligjin nr. 8969, date 07.11.2002, “Per disa masa ne fushen e transmetimeve radiotelevizive”, disa operatore kane ndryshuar vendvendosjen e transmetuesave, fuqite, diagramat e antenave, ose dhe kane instaluar transmetues te rinj, pa miratuar frekuencat. KKRT i ka evidentuar te gjitha keto raste dhe ka vepruar konform ligjit per rivendosjen e gjendjes. Ne aneksin bashkengjitur (Aneksi 1) paraqitet ne menyre te detajuar gjendja e mbulimit te realizuar nga impiantet e licencuara dhe te palicencuara te çdo operatori. **Perveç masave te tjera per ndeshkimin e shkeljeve, respektimi i ligjit “Mbi disa masa ne fushen e transmetimeve radiotelevizive”**, i cili eshte i evidentuar sakte per çdo operator, **do te perbeje nje nga kriteret e rendesishem gjate vleresimit te licencimit provizor te transmetimeve jashtë zones se licencimit**, qe u trajtua me siper, dhe sidomos do te jete kriter baze per rilicensimin.

2.5.15. Bashkepunimi me institucionet e tjera, percaktimi i procedurave

2.5.15.1 Bashkepunimi me ERT dhe Policine Tatimore

Per zbatimin e ligjit dhe vendimeve te KKRT-se, eshte i nevojshem ngritja ne nje nivel me te larte cilesor i bashkepunimit me te gjitha strukturat e tjera te shtetit, sidomos me institucionet e tjera te interesuara, si Ministrine e Financave, Drejtorene e Doganave,

DPPT, ERT, organet e pushtetit vendor, organet fiskale ne qender e ne baze, etj. Me ERT eshte percaktuar procedura e dhenies se Lejeve per perdorimin e frekuencave per sherbimet fikse pike me pike, te operatoreve radio e televizive dhe po punohet per te percaktuar proceduren e dhenies se lejeve per ndertimin e rrjetete te operatoreve TV me kabell. Percaktimi dhe aplikimi i procedures per dhenien e Lejeve per perdorimin e frekuencave per sherbimet fikse pike me pike, ka disiplinuar perdorimin e frekuencave ne brezat qe administrohen nga ERT, duke vendosur baza te shendosha per stabilizimin e gjendjes. Tashme, KKRT nuk lejon hyrjen ne fuqi te licences se nje operatori, nese ai nuk ka marre lejen nga ERT per perdorimin e frekuences se link-ut (nese parashikohet perdorimi i nje frekuence te tille).

Kete vit, ne vijim te bashkepunimit te frytshem qe kemi stabilizuar me ERT, jane zhvilluar matje me ekipe te perbashketa dhe jane zgjidhur probleme te interferencave, duke shfrytezuar dhe pajisjet teknike te KKRT-se .

2.5.15.2 Disiplinimi i importimit te aparaturave transmetuese

Aktualisht, çdo subjekt qe disponon nje licence per transmetime radio apo televizive, mund te importoje nje numer te pakufizuar pajisjesh transmetuese, pavaresisht se eshte i autorizuar t'i instaloje apo jo. Jane konstatuar edhe raste kur, edhe subjekte te palicencuar per transmetime radio apo televizive, kane importuar apo blere ne vend pajisje transmetuese dhe i kane futur ato ne transmetim, pa lejen perkatese.

Per vitin ne vazhdim KKRT, nepermjet koordinimit me ERT dhe me Drejtorene e Pergjithshme te Doganave do te vendose rregulla per miratimin e pajisjeve qe importohen, duke lejuar importin e vetem atyre pajisjeve qe do te kene nje projekt te miratuar nga KKRT.

2.5.15.3 Koordinimi me fqinjet

Per shmangien e interferencave reciproke, bashkeveprimi me organizmat nderkombetare te specializuara (ITU) dhe ato rregullatore te vendeve fqinje, eshte i domosdoshem. Objektivi i bashkepunimit eshte kembimi i informacionit reciprok, qe do te ndihmoje ne identifikimin e stacioneve, qe shkaktojne interference dhe ne nderhyrjen prane shkaktareve per te reduktuar keto interference. Kete vit, KKRT ka derguar nje informacion te hollesishem (bazuar nga te dhenat e Hartes se Frekuencave) prane ERO (European Radiocommunication Office). Keto te dhena, tashme figurojn ne data base-n e ERO dhe mund te konsultohen nga te gjithe te interesuarit.

Ne muajin Korrik 2003 u organizua vizita e nje ekipi ekspertesh te KKRT-se prane AGCOM (Autorita per le Garanzie nelle Telecomunicazioni), qe eshte organi rregulator i Italise edhe per transmetimet radio e televizive. Vizita i sherbeu njohjes reciproke dhe kembimit te informacionit ne fushen Juridike te Programeve, Ekonomike dhe te Administrimit te Frekuencave. Ne kuadrin e kembimit te experiences, nga ana e AGCOM na u ofrua nje trajnim 1-javor per dy specialiste te KKRT-se qe u zhvillua ne muajin Tetor 2003. Per planifikimin e vijimit te bashkepunimit, pritet qe ne Shqiperi te vije nje ekip i AGCOM.

Deri tani jane vendosur kontakte edhe me organin rregulator te Maqedonise.

Per vitin ne vazhdim, KKRT ka programuar punen per te kontaktuar dhe bashkevepruar me organet rregulator te Italise, Malit te Zi, Kosoves, Maqedonise dhe Greqise. KKRT synon qe, bashkepunimin me vendet fqinje, pervec kembimit te thjeshte

te te dhenave, ta shfrytezoje edhe per kembimin e eksperencies dhe kualifikimin e stafit te vet.

2.5.16.Operatoret e transmetimeve analoge tokesore

2.5.16.1 Operatoret vendore radio e Tv te licencuar per transmetime analoge tokesore

Ne vitin 2003 si rezultat i nje pune me te planifikuar e te kualifikuar me operatoret, jane arritur nivele te reja ne bashkepunimin per zgjidhjen e problemeve programore, ekonomike e teknike.

Ne per gjithesi operatoret radio dhe televizive kane operuar ne perputhje me ligjin dhe kushtet e licences.

Viti 2003 shenoi perpjekjet e para per profilizimin e disa operatoreve radio po sidomos televizive. Si rezultat i veprimit te mekanizmave te tregut eshte evidentuar edhe nje fare diferencimi i operatoreve, ne perputhje me cilesine e programeve qe ofrojne dhe te ardhurave qe sigurojne. Kjo gjendje pasqyrohet edhe ne permbushjen e detyrimeve per mbulimin e zones se licencimit. Operatoret e suksesshem kane vazhduar zgjerimin e zones se mbulimit, duke rritur audiencen ne zonen e tyre te licencimit. Perkundrazi, jane evidentuar operatore qe si rezultat i problemeve tashme te mprehta financiare nuk i kane plotesuar detyrimet e tyre per mbulimin, duke e reduktuar ate. Shembulli tipik ishte ALBA TV, qe u mbyll per arsy thjesht financiare.

Aneksi nr. 1 pasqyron ndryshimet ne mbulimin e realizuar nga operatoret radio e televizive ne krahasim me fundin e vitit 2002.

Ne tabelen e aneksit nr. 2 bashkengjitur, jepet edhe gjendja e mbulimit te realizuar nga secili operator mbi territorin e Shqiperise. Aneksi 3 paraqet ndryshimet e mbulimit me sinjal te realizuar nga secili operator televiziv ne krahasim me vitin 2002.

Siq permendet edhe me siper, edhe gjate vitit 2003 nje numer operatoresh transmetuan nga pika jashte zones se tyre te licencimit, pa u kujdesur te permiresojne mbulimin e zonave per te cilat jane licencuar, qe perbejne detyrimin kryesor te tyre kundrejt KKRT dhe komunitetit vendor. Ne pritje te zgjidhjes se propozuar, KKRT eshte kufizuar ne ruajtjen e status quose, sidomos per te mos perkeqesuar gjendjen persa i perket interferencave, por, e theksojme, pa gjetur respekt per ligjin dhe autoritetin rregullator nga nje numer operatoresh qe abuzojne. Disa operatore, vazhdojne te zgjerojnë mbulimin e paautorizuar, gjithmone duke mos kryer asnje detyrim shtese. Keto ndryshime paraqiten ne skicat e aneksit nr.1.

Nje gjendje e tille jo normale, evidenton domosdoshmerine e zgjidhjes se propozuar, perpara fillimit te procedurave te rilicencimit te operatoreve vendore per transmetime analoge.

Ndonese ne shpalljen e konkurrimit te kandidaturave per operatore televizive vendore, KKRT, gjate vitit 2003 i ka dhene prioritet zonave te largeta, mbulimi me sinjale vazhdon te mbetet i perqendruar ne zonat si Tirana, Durresi, Fieri, Vlora, Shkodra, Gjirokastra e Korça.

2.5.15.2.Operatoret Private Kombetare

Ne tabelen e meposhtme jepet mbulimi me sinjal i territorit te Shqiperise i realizuar nga operatoret private kombetare radio dhe televizive ne fund te vitit 2003, i krahasuar me te dhenat e vitit 2002.

Nr.	Operatori	Licenca	Mbulimi		
			Fundi 2002	Fundi 2003	Det. Lic. 2003
1.	Top Albania Radio	Radio Kombetare	87.22	87.22	55.76
2.	Radio +2	Radio Kombetare	72.11	72.11	55.76
3.	TV Arberia	TV Kombetar	27.39	30.1	26.4
4.	TV Klan	TV Kombetar	40.91	42.68	26.4

Shenim: Llogaritjet e mbulimit jane kryer, duke marre si nivel marrjeje nivelin 60 dB (μ V/m), qe siguron nje mbulim cilesor e te garantuar ne zonat ku ekziston influenca e kanaleve te vendeve fjinje, sic eshte zona e Ultesires Perendimore te Shqiperise.

Siq shihet, progresi, sidomos ai i realizuar nga operatoret televizive per vitin e kaluar, nuk eshte i madh. Mbulimi qe operatoret e mesiperm duhet te arrijne ne perputhje me detyrimet e licences, ne fund te vitit 2004 eshte 46,9 % te territorit shqiptar.

Nga ana e KKRT jane percaktuar frekuencat qe u duhen ketyre operatoreve per te mbuluar gjithe territorin e vendit si dhe pikat kryesore te transmetimit.

KKRT eshte e mendimit se shkak i ngadalesimit te ritmeve te mbulimit me sinjal analog tokesor televiziv ka qene interes i operatoreve per te realizuar transmetime satelitore, qe u be realitet nga fundi i vitit, duke okupuar natyrisht burime te konsiderueshme financimi.

Ndersa inkurajon shtimin e games se sherbimeve te ofruara, ne perputhje me kerkesat e ligjit, KKRT do te vazhdoje te nxite respektimin e detyrimeve per mbulim me sinjal analog tokesor, i cili garanton aksesin ne informacion dhe kulture te segmenteve te pa favorizuara te popullsise, sidomos te popullsise rurale qe nuk i ka mjetet per te perballuar blerjen e marresave satelitore.

Per sa u trajtua me siper KKRT i ka terhequr vemendjen e te dy operatoreve private kombetare dhe i ka paralajmeruar se shhangja nga detyrimet e licences do te merret ne konsiderate ne fund te periudhes se licencimit gjate shqyrtimit te leshimit te licences se re.

2.5.16.3. RTSH

Gjendja e mbulimit te territorit te Republikes me sinjalin e operatorit te vetem publik, Radiotelevizionit shqiptar, eshte respektivisht:

Radio Tirana mbulon 80.54 % te territorit te Shqiperise,

TVSH mbulon 73.3 % te territorit te Shqiperise.

Neni 71 i ligjit "Per radion dhe televisionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise percakton:

"Programet e RTSH-se duhet te mbulojnë territorin e banuar nga te pakten 90 per qind e shtetasve te Republikes se Shqiperise.

Brenda 5 vjetesh nga dita e miratimit te ketij ligji, te pakten njeri nga programet e RTSH-se duhet te mbuloje 99 perqind te popullsise".

3. PROBLEME TE BUXHETIT PER VITIN 2003 DHE 2004 DETYRIMET E OPERATOREVE RTV

1. Realizimi i fondeve te buxhetit

Per vitin 2003, buxheti ne zerin “Shpenzime operative” dhe “Investime” per Keshillin Kombetar te Radios dhe Televizionit nga 73 **milion** leke te planifikuara, eshte realizuar 35.8 **milion** leke, ose 48.7 perqind.

Realizimi i shpenzimeve sipas struktura paraqitet si me poshte:

	Ne milion leke			
	Plan	Fakt	Dif.	%
Shpenzime operative	33	32.8	0.2	99.3
Investime	40	2.8	37.2	7
- Gjithsej	73	35.6	37.4	48.7

• Realizimi i fondeve ne zerin “Shpenzime operative”

Plani i shpenzimeve operative, ne masen prej 33 milion leke i detajuar ne zera per vitin 2003 u realizuan ne masen 32.8 milion leke ose 99.3 perqind i detajuar ze per ze si me poshte:

Shpenzimet	Plani	Fakti	diferenca	%
1.Pagat e shperblimet e anetareve te KKRT-se	20	20	0	100
2.Sigurimet shoqerore	3.8	3.8	0	100
3.Shpenzime te ndryshme	9.2	9	0.2	99.3
Gjithsej	33	32.8	0.2	99.3

• Valuta jo tregtare

Ne mbeshtetje te urdherave perkatese te dala per kete qellim gjate vitit 2003 institucioni yne ka perdonur rreth 16864 **USD** te detajuar si me poshte:

Shpenzime per udhetim e dieta	15252
Shpenzime per pagese kuotizacioni EPRA	1612
Gjithsej	16864

Kundravlefta ne leke te valutes se papaperdorur mbeti gjendje per t'u perdorur brenda vitit 2003, ne zerin shpenzime operative.

- **Te ardhurat**

Krahas fondeve buxhetore, KKRT ka realizuar te ardhura, te cilat jane depozituar ne llogarine tone ne Banken e Kursimeve, Dega nr. 1 me miratimin e Ministrise se Financave. Te ardhurat e realizuara kane qene pagesat qe kane bere subjektet per pagesen vjetore per licence dhe pagesat per marrjen e licences. Te ardhurat e trasheguara dhe te realizuara per vitin 2003, **deri ne diten e sotme** jane 68.5 milion leke, fonde keto ne dispozicion te institucionit tone.

- **Realizimi i fondeve ne zerin Investime**

Plani i investimeve per vitin 2003, nga 40 milion leke u realizua 2.8 milion leke, ose rreth 7 perqind.

Realizimi i investimeve ne strukture paraqitet si me poshte:

Emertimi	Plan	Fakti	Ne milion leke	%
• Perpunimi i Planit Kombetar te Frekuencave	10	0	0	0
• Rikonstrukcion	20	0	0	0
• Pajisje zyre	5,0	0.6	0.6	12
• Blerje pajisje operacionale	5,0	2.2	2.2	44
<i>Shuma</i>	40	2.8		7

Perpunimi i Planit Kombetar te Frekuencave

Gjate vitit 2003, nga KKRT jane miratuar kriteret e hartimit te Planit te Frekuencave, e strategjise afatmesem dhe afatgjate te zhvillimit te industrise se medias elektronike, si dhe çelja e gares per percaktimin e firmes konsultuese. Eshte perqatitur gjithashtu edhe projekti i kerkeses per shfaqjen e interesit per te marre pjesë ne garen per percaktimin e konsulentit. Ky projekt u eshte derguar disa institucioneve qendrore te vendit e organizmave te huaja per verejtje, mendime apo kontribute me donacione. Per shkak te procedurave, perqigjja e kerkeses eshte vonuar, madje disa institucione kryesore si: Ministria e Bashkepunimit Ekonomik, akoma nuk kane dhene perqigje. Kjo na detyron te shtyjme fillimin e konkurrmit.

Rikonstrukcion

Realizimi i ketyre fondeve ishte i kushtezuar me sistemimin perfundimtar te KKRT-se ne ish- Hotel “Drini” ku, aktualisht ne kemi nen administrim katin e IV dhe te V te kesaj godine, por nuk mund te benim rikonstrukcionin ne keto ambiente, mbasi eshte prone e Drejtorese se Pergjithshme te Doganave.

Per kete problem, ne tre vitet e fundit ka nje praktike te gjere shkencore me institucionin e Keshillit te Ministrave, Kuvendit te Shqiperise, Ministrise se Financave etj, dhe ne muajin shtator te ketij viti u arrit nje akt-marreveshje midis KKRT-se dhe Drejtorese se Pergjithshme te Doganave per kryerjen e rikonstrukzionit. Meqenese periudha kohore deri ne fund te vitit nuk ishte e mjaftueshme per prokurimin e fondeve, pasi afati i percaktuar per perdorimin e fondeve buxhetore per vitin 2003, ishte deri ne 30 tetor 2003, keto fonde nuk mund te realizoheshin kete vit. Me fonde e veta te institucionit u realizua tenderi per studimin e projektimin e rikonstrukzionit te godines. Rikonstrukioni do te realizohet me fonde e vitit 2004.

Pajisje zyre

Gjate vitit 2003 ne kete ze shpenzimesh kemi patur ne dispozicion per te realizuar 5 **milion** leke pajisje zyre, kur deri ne fund te vitit, realizimi eshte ne shumen prej 600 mijë leke, me nje difference ne shume absolute prej – 4.4 milion leke. Realizimi i fondeve ne zerin pajisje eshte e kushtezuar me realizimin e rikonstrukzionit te godines se KKRT-se.

Ne zbatim te Urdherit te Kryeministrit nr. 72, date 15.05.2003, eshte raportuar çdo muaj nga ana jone per realizimin e investimeve, sipas zerave dhe tabelave perkatese.

Blerje pajisje operacionale

Per vitin 2003 ne kete ze kemi pasur ne dispozicion per te realizuar 5 milion leke, jane realizuar 2.2 milion leke, me nje mosrealizim ne shumen prej 2.8 milion leke.

Dhurimet

Per vitin 2003, nuk kemi pasur donacione. Donatore te ndryshem si: Mbreteria e Danimarkes, me projektin Danida dhe IREX PRO Media per vitet 2000-2002, na kane financuar per **350.416** dollare.

2. Detyrimet e operatoreve radiotelevizive

• Pagesat per licence

Pagesat per licence vjetore per operatoret Radio FM dhe TV per vitin 2003, nga 34 milione e 91 mijë leke, jane realizuar ne 26 milion e 63 mijë leke, ose 76.4 perqind.

Operatoret radio FM kane realizuar pagesat per licence ne masen e planifikuar prej 5 milion e 769 mijë leke, ose 100 perqind.

Operatoret TV kane realizuar pagesat per licence ne shumen prej 20 milion e 294 mijë leke, ose 72 perqind.

• Pagesat per taksat

Taksat per sherbimet radiotelevizive per operatoret e trasmetimeve FM dhe TV jane realizuar 8 milion e 391 mijë leke, nga 11 milion e 930 mijë leke te planifikuara, ose 70 perqind.

Operatoret Radio FM kane derdhur detyrimin per taksa ne masen e planifikuar prej 1 milion e 479 mijë leke, ose 100 perqind.

Operatoret TV kane derdhur detyrimin per taksat nga 10 milion e 451 mijë leke te planifikuara, ne 6 milion e 911 mijë leke, ose 66 perqind.

* Realizimi i detyrimeve te pagesave te operatoreve, si numer dhe ne vlefte absolute paraqitet sipas tabelave 1 dhe 1/1.

3. Detyrat qe dalin per vitin 2004

Analiza e tregut te trasmetimeve radio e televizive

Sipas vleresimeve te shume specialisteve, shqiptare dhe te huaj, tregu i trasmetimeve radio e televizive te Shqiperise paraqitet si nje treg i pazhvuilluar, i pabalancuar per te mos thene i deformuar, qe nuk siguron mbeshtetje te nevojshme financiare per mbijetesen e numrit te ekzagjeruar e te pajustifikuar te operatoreve, sidomos te operatoreve televizive.

Konstatimi i mesiperm argumentohet duke analizuar ne menyre te per gjithshme elementet e me poshtem ekonomike:

1. Te ardhurat

Te ardhurat kryesore te operatoreve radio e televizive sigurohen kryesisht nga reklamat. Tregu i reklamave eshte i perqendruar kryesisht ne Ultesiren Perendimore, sidomos ne Tirane dhe me pak ne Durres. Ekzistojnë edhe disa biznese relativisht te fuqishem te stabilizuar ne zonen e Gjirokastres. Nuk eshte rastesi qe ne zonen e Tiranes dhe ne Ultesiren Perendimore ofron sherbim shumica e operatoreve televizive (75 % dhe radio 71.6 %), per fshire dhe operatoret kombetare). Edhe zona e Gjirokastres konsiderohet si zone e lakuar nga operatoret. Eshte fakt qe kompanite e fuqishme shteterore, por edhe private, si KESH, ALBTELECOM, AMC, VODAFONE, INSIG, bankat etj, perdonin si kriter vleresimi per shperndarjen e reklamave mbulimin me sinjal te territorit. Kjo eshte dhe nje nga arsyet kryesore te kerkesave e presioneve nga shume operatore per tu shpalluar operatore kombetare.

Zhvillimi i pamjaftueshem i ekonomise shqiptare, me potencialin e kufizuar te reklamave qe rrjedh prej tij eshte faktori kryesor penges edhe per zhvillimin e nje tregu te konsoliduar te reklamave. Nga bilancet e depozituara ne Keshillin Kombetar te Radios dhe Televizonit rezulton se rreth 46 perqind te te ardhurave te siguruara nga subjektet, jane te ardhura te realizuara nga reklamat, rreth 49 perqind jane te ardhura te realizuara nga burime te tjera, dhe rreth 5 perqind jane te ardhurat te realizuara nga sponsorizime dhe donacione te ndryshme.

2. Shpenzimet

Investimet per krijimin e nje rrjeti cilesor trasmetimi radio apo televiziv, jane te konsiderueshme. Shumica e operatoreve, sidomos ata vendore, per te reduktuar investimet, kane instaluar pajisje te perdonura qe nuk sigurojne qendrueshmerine e cilesine e deshiruar te sherbimit. Mbajtja ne gadishmeri dhe riparimi i pajisjeve te perdonura, kerkon angazhimin e mjeteve te konsiderueshme financiare gjate periudhes se shfrytezimit. Eshte fakt se shume nga operatoret vendore, sidomos ata te cilet jane

licencuar per kater prefektura, per shkak te kostove te larta te investimit dhe mirembajtjes, paraqiten me tregues te ulet te mbulimit te zones se tyre te licencimit.

Ne veprimtarine radiotelevizive, perveç investimeve per ndertimin e rrjetit e te studiove, investimi kryesor aplikohet ne veprimtarine prodhuese, qe per karakteristikat dhe kerkesat e vecanta ka kosto te larte, per pasoje vetem nje numer shume i kufizuar operatoresh radio e televizive jane ne gjendje te prodhojne apo te blejne programe artistike, filma, evenimente sportive, etj.

Konkluzion

Kostot e larta te mirembajtjes dhe te prodhimit te programeve, te ardhurat e uleta te siguruara nga tregu i pazhvilluar e i deformuar i reklamave, nuk japin garanci per sigurimin e qendrueshmerise ekonomike te shumices se operatoreve radio e televizive.

Konstatimi nga shqyrtimi i bilanceve te veprimtarise ekonomike e financiare te paraqitura nga subjektet eshte se, shumica e operatoreve radio e televizive perdon te ardhura nga veprimtari te tjera qe nuk kane lidhje me veprimtarine radio apo televizive. Nga te dhenat qe kemi, rezulton edhe formalisht se operatoret radio FM, me te ardhurat e siguruara arrijne te mbulojne shpenzimet dhe te sigurojne nje fitim minimal, ndersa nuk paraqitet e njejtta situate me operatoret TV te cilet (rreth 50 perqind e tyre rezultojne me humbje). Nje gjendje e tille forcon dyshimet se operatore te tille radio e televizive financohen nga burime jashtे aktivitetit per te cilet jane licensuar, pra, krijon mundesi per financime te paligjshme dhe per perdonimin e mediave per perpunimin e opinionit ne favor te grupeve te caktuara.

Te nderuar deputete,

Problemet qe parashtruam ne kete raport, arritjet por sidomos dobesite, edhe te rregullatorit, kerkojne vemendje te veçante, kerkojne analize te vazhdueshme e zgjidhje. Komuniteti i mediave elektronike dhe rregulatori, pas ketij tranzicioni te zgjatur, qe ende vazhdon, ndodhen para nje realiteti te ri problematik: do te konsolidohen si biznese e do te rriten profesionalisht, duke respektuar ligjin e kushtet e licences, apo do te falimentojne?

Mediat tona elektronike jane nen trysnine e nje tregu te pamjaftueshem reklame, ku ne menyre te ligjshme do te krijonin burimet e tyre te financimit; per te mbijetuar, kerkohen suporte, sidomos nga politika, duke u perdonur ndersjelltas, duke cenuar identitetin e pavaresine.

Respektimi i standarteve te percaktuara ne ligj, i detyrimeve per te drejtat e transmetimit, i detyrimeve fiskale, i transparences se shpenzimeve e te ardhurave, permes bilanceve, i kushteve per programet dhe cilesine e sinjaleve do t'i vinte ato ne starte konkurrence te ndershme, pas te cilave suksesi ose deshtimi do te vinin nga menaxhimi.

Bilancet e plota, te pranuara sipas ligjit nga strukturat fiskale, dhe transparenca e plete edhe nga vete operatoret, qe ende s'jane te tilla, do te tregonin gjendjen reale, madje do te rrisnin besueshmerine e tyre para audiences, ne radhe te pare, por edhe ndaj biznesit, qe reklamon produktet e veta.

Perpjekjet qe po behen ne keto drejtime nga nje numer operatoresh jane inkurajuese, por ende jo te plota: eshte e domosdoshme qe keto standarte te realizohen teresist e nga te gjithe.

Mediat elektronike po luajne nje rol te pazevendesueshem ne informimin e njerezve per gjithcka ndodh; duke u emancipuar vete ata, ne ecje e siper po ndikojne per emancipimin e shoqerise, te vete politikes. Realisht po kthehen ne pushtet te katert. Pasqyrimi korrekt i fushates zgjedhore Totor 2003, informacioni i shpejte e ne kohe i tragedise se dhimbshme te 9 janarit, fushata humanitare ne ndihme te familjeve ne fatkeqesi tregojne ç'dimensione zene ato sot ne jeten e shoqerise, ne proceset demokratike.

Por as mediat nuk kane imunitet nga rreziku: si çdo pushtet, edhe pushteti i medias mund te keqperdoret: problemet e mesiperme, veshtiresite qe perballojne, rendom, i shtyn ato t'i bejne "koncesion" politikes, per te perfituar mbeshtetjen e saj edhe kur shkelet ligji, apo potencialisht te behen edhe pre e krimi, apo me keq, te kontrollohen nga krimi.

E ndiejme detyrim, jo thjesht moral, te paralajmerojme per rreziqe te tilla edhe ligjvenesit, per t'i parandaluar ato.

Nje media vertet e lire eshte kurdochere e pergjegjshme. Teprimi, qe vihet re ne mjaft raste, eshte shprehje jo vetem e shkeljeve te standarteve profesionale, por edhe e atributit te fjales se lire. Per kete dukuri, nje analist me te drejte shkruan "Ekrani nuk eshte vetem nje krijues i madh imazhesh, por edhe nje konsumator i frikshem i tyre".

Nga statistikat, produkt i monitorimit, vihet re se, p.sh.: politika eshte e pranishme ne ekran vend e pa vend, si rregull, konsumohet politike, por nuk prodhohet politike: ne programe te tilla s'ka produkt: konsumohen te dy: edhe ekrani edhe politikani.

Nje ekspert i njojur polak, i derguar nga Keshilli i Europees ne nje takim per probleme te ngjashme te medias ne Shkup tha se vendet postkomuniste, jane kolonizuar duksheem nga partite, por ende s'eshte ne raporte te kenaqshme demokracia.

"Popullimi" i ekraneve nga politika, per analogji, s'do te thote se i demokratizon ato, edhe pse eshte shprehje e qarte e hapjes ndaj opinioneve te kunderta.

KKRT ka bindjen se praktikat e permendura me lart, edhe problemet e parashtruara ne kete report, duan zgjidhje: konsensus e transparence sa me te gjere per nxjerrjen e akteve ligjore e nenligjore, nga vete komuniteti, rregulatori e ligjvenes, konsensus, mbeshtetje e transparence ne zbatimin e ketyre akteve, gjithashtu nga vete komuniteti i mediave, rregulatori e ligjvenes. Arbiter, kur s'ka alternative tjeter, te jete gjykata.

Propozimet ne raport dhe Plani i Veprimit qe paraqesim per miratim, shpreh vullnetin tone per zgjidhjen e problemeve te mediave elektronike, pare ne prespektiven zhvillimore te kesaj industrie, duke mos iu drejtuar se pari, masave shtrenguese.

Rilicensimi per radiot vendore FM, te cilave u perfundoj afati ligjor ne fund te vitit 2003, permis nje rregulloreje te bere ne kohe transparente, ishte nje proces-pervoje per ne dhe operatoret per t'iua drejtuar, te dy palet, kushteve te ligjit: s'mund te kualifikoheshin e rilicencoheshin ato subjekte qe ishin debitore ndaj ligjit. Kjo prove u kalua me sukses.

Na inkurajon ky fakt, sepse po tregohet vullnet nga operatoret per te respektuar ligjin, por edhe se KKRT s'ka asnje motiv te heqe licenca.

KKRT kerkon nga ky kuvend i larte, mbeshtetjen ne zbatim te ligjit: behet fjale jo per fatin tone personal, por per te ardhmen e medias, aq te nevojshme per nje shtet demokratik te se drejtes dhe per nje shoqeri te hapur qe shpreson.

Ne vendimmarrje ka patur raste qe jemi kontestuar nga politika, madje edhe nga ligjvenes politikane te pozites e opozites.

E themi hapur se nuk jemi imune nga gabimet. Probleme te kompozimit e perfaqesimit te organit tone vendimmarres, qe nuk varen prej nesh, por te rr Ethanave kur u konstituua ky organ, kane çuar ne paragjykime, qe cenojne autoritetin e institucionit dhe ndikojne ne sjelljen ndaj ligjit.

Ndikojne edhe ne vendimmarrjen tone. Eshte kjo arsyaja qe disa vendime te rendesishme si: shpallja e konkurrimit per nje operator te trete privat kombetar, e konkurrimit per operatore rajonale, e paraqitjes se strategjise zhvillimore te medias elektronike etj, jane parashikuar pas muajit korrik, muaj kur perfundon mandati i nje numri anetaresh te Keshillit.

Me besimin se i sherben nje vendimmarrjeje te plote, ligjore, profesionale e te pakontestueshme, kurdohere ne dobi te medias e te autoritetit te ligjit dhe te organit te ngarkuar per zbatimin e tij, personalisht, qe sot, jam i gatshem per çdo zgjidhje ligjore.

Ju stoj, te nderuar deputete, te miratoni raportin dhe Planin e Veprimit, duke besuar plotesisht se veprimitaria e KKRT-se do te ndikoje pozitivisht per mbarevajtjen e punes ne kete fushe me mision te madh per gjithe shoqerine.

KKRT- KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT**PLAN VEPRIMI PER VITIN 2004**(Miratuar me Vendimin nr. 214, date 30/01/2004)

Ne perputhje me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise,

Ne zbatim te misionit te percaktuar ne nenin 6 te ligjit nr. 8410, date 30.09.1998, "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise", ndryshuar me ligjin nr 8655, date 31.07.2000, ndryshuar me ligjin nr 8794, date 10.05.2001", ndryshuar me ligjin nr. 9124, date 29.07.2003":

Per rregullimin dhe mbikqyrjen e veprimtarise radiotelevizive ne Republiken e Shqiperise,

Ne perputhje me kuadrin e pergjithshem ligjor te Republikes

Bazuar ne kompetencat e parashikuara ne nenin 7 te ligjit te permendor me siper, KKRT, per vitin 2004, percakton Planin e Veprimit si vijon:

1. Perfundimi i rilicencimit te operatoreve vendore radio

JANAR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

2. Riorganizimi i spektrit te frekuencave televizive te rajonit te Tiranes

- a. Percaktimi i operatoreve vendore e kombetare qe do te transmetojne deri ne fund te viti 2005 (fundi i periudhes se licencimit per operatoret lokale TV) nga mali i Dajtit.

- b. Organizimi i diskutimit teknik me secilin operator dhe fiksimi i karakteristikave individuale te transmetimit te pajisjeve transmetuese

JANAR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- c. Kontaktimi me te gjithe operatoret e rajonit te Tiranes mbi masat per organizimin e kalimit te menjehershem ne frekuencat e caktuara
- d. Caktimi i afatit te kalimit dhe njoftimi i operatoreve te rajoneve perrreth Tiranes mbi interferencat qe mund te ndodhin perkohesisht pas kalimit te operatoreve te Tiranes ne frekuencat definitive
- e. Realizimi i kalimit dhe evidentimi i ndryshimit te gjendjes

JANAR – SHKURT 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

3. **Pajisja me leje per Transmetime satelitore te operatoreve te licensuar per transmetime analoge tokesore, qe kane dale ne transmetim Satelitor**

- a. Identifikimi i operatoreve vendore e kombetare qe transmetojne ne rruge satelitore dhe njoftimi zyrtar per paraqitjen e aplikimit ne perputhje me ligjin “Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise” dhe rregulloren “per transmetimet e programeve radiotelevizive tokesore me satelit dhe anasjelltas”.

JANAR – SHKURT 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- b. Shqyrtimi i aplikimeve nga Komisioni i Vleresimit dhe paraqitja per miratim prane Keshillit Teknik me secilin operator dhe fiksimi i karakteristikave individuale te transmetimit te pajisjeve transmetuese

MARS 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEOPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- c. Miratimi i Lejeve nga Keshilli

PRILL 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- d. Marrja e masave per mbylljen e transmetimeve satelitore nga subjekte qe eventualisht nuk do te aplikojne per Leje per transmetime satelitore

PRILL 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

4. Procedurat per licensimin e operatorit te trete privat kombetar televiziv

- a. Percaktimi i frekuencave ne secilen nga pikat e transmetimit per te siguruar krijimin e rrjetit te operatorit te trete

SHKURT 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- b. Llogaritjet e parametrave te transmetimit dhe interferencave te transmetuesve te rrjetit te operatorit te trete

SHKURT 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

c. Pergatitja e dokumentacionit te konkurrimit te kandidaturave per licencimin e operatorit te trete

MARS 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

d. Organizimi i konkurrimit te kandidaturave per licencen e trete private kombetare televizive

KORRIK - GUSHT 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

e. Shpallja e fituesit

SHTATOR 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

5. Pergatitja e dokumentacionit per operatoret private radio e televizive rajonale

a. Studimi gjeografik, ekonomik, demografik per percaktimin e rajoneve te Shqiperise, ku do te shtrihet veprimtaria e TV rajonale

MARS 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

b. Paraqitja e studimit per vleresim e mendim prane operatoreve, institucioneve shteterore e organizmave kombetare e nderkombetare te interesuara

PRILL 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

c. Studimi i verejtjeve e sugjerimeve dhe reflektimi ne materialin perfundimtar qe do te miratohet nga Keshilli Kombetar

PRILL 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

d. Paraqitja e materialit ne Komisionin Parlamentar te Mjeteve te Informimit Publik.

MAJ 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

6. Procedurat per licencimin e operatoreve private rajonale televizive

a. Percaktimi i frekuencave ne secilen nga pikat e transmetimit per te siguruar krijimin e rrjeteve rajonale, ne përputhje me kriteret e hartimit te Planit Kombetar te Frekuencave televizive, te miratuara nge KKRT me vendimin nr. 140, date 30.04.2003

SHKURT 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK

b. Llogaritjet e parametrave te transmetimit dhe interferencave te transmetuesve te rrjeteve rajonale

MARS 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK

f. Pergatitja e dokumentacionit te konkurrimit te kandidaturave per licencimin e operatoreve rajonale

MAJ 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

**DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

g. Organizimi i konkurrimit te kandidaturave per licencat rajonale televizive

**SHTATOR – TETOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE**

h. Shpallja e fituesve

**NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE**

7. Evidentimi i gjendjes se transmetimeve radio e televizive ne fund te vittit 2004

a. Organizimi i marrjes se informacionit nga operatoret per zbatimin e detyrave per mbulimin e zones se licencimit per vitin 2003

**JANAR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE**

b. Verifikimi i te dhenave

**JANAR 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK**

c. Raportimi i rezultateve ne Keshill dhe propozimi i masave per rregullimin e gjendjes

**SHKURT 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE**

- d. Publikimi i te dhenave ne Internet dhe ne buletin

SHKURT 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

8. Zgjidhja e problemit te transmetuesve televizive te instaluar jashte zones se licencimit

- a. Llogaritja e evidentimi per secilin subjekt, i detyrimeve per licence dhe taksat per frekuencat e papaguara

SHKURT - MARS 2004
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- b. Pergatitja e kushteve per licencat provizore, deri ne fund te periudhes se licencimit te secilit operator vendor dhe njohja e operatoreve me keto kushte

MAJ 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

- c. Pajisja e operatoreve me licencat provizore

KORRIK 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

9. Puna me operatoret

- a. Udhezim per identifikimin e pajisjeve transmetuese ne te gjitha pikat transmetuese, si dhe percaktimi i detyrimeve per strehuesit e pajisjeve transmetuese, per te parandaluar transmetimet e palicencuara

SHKURT 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- b. Organizimi i punes per plotesimin e dokumentacionit te frekuencave ne dispozicion te operatoreve, nepermjet dhenies se lejeve te perdorimit te frekuencave dhe targetave identifikuase qe do t'u ngjiten pajisjeve transmetuese

MARS – KORRIK 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK

10. Pergatitjet per rinovimin e licencave per operatoret, te cileve u perfundon periudha e licencimit ne fund te vitit 2004

- a. Krijimi i evidencave qe evidentojne sjelljen e operatoreve gjate periudhes se licencimit

MAJ 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMeve
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

- b. Shpallja e listes se operatoreve qe perfundojne periudhen e licencimit deri me 31.12.2004 dhe e kritereve te rivleresimit

MAJ 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

- c. Vleresimi i sjelljes se operatoreve qe perfundojne periudhen e licencimit ne fund te 2004

SHTATOR 2004

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

d. Raportimi ne Keshill dhe propozimi i vendimit perkates te tij

TETOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

e. Shpallja e ftesave per riaplikim sipas frekuencave dhe zonave perkatese te mbulimit

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

f. Organizimi i shqyrtimit te aplikimeve per rinoimin e licencave dhe shpallja e fituesve

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

DETYRA TE POLITIKES E STRATEGJISE**1. Perpunimi dhe miratimi i strategjise e politikes se zhvillimit dhe planit kombetar te frekuencave per brezat RTV**

- a. Shpallja e gares per percaktimin e e kompanise se huaj konsultuese

MARS 2004
KKRT

- b. Caktimi i komisionit te vleresimit te ofertave ne perberje te te cilit do te kete perfaqesues te OSBE, BE, ERO

MARS 2004
KKRT

- c. Percaktimi i kompanise fituese dhe lidhja e kontrates

QERSHOR 2004
KKRT

- d. Organizimi i terheqjes se informacionit, mendimeve dhe kontributit te institucioneve e organeve te interesuara te vendit mbi drejtimet e rruget e zhvillimit te transmetimeve radio e televizive, qe do te shfrytezohen ne hartimin e strategjise se zhvillimit dhe planit te frekuencave

QERSHOR - KORRIK 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- e. Organizimi i konsultimeve me operatoret per domosdoshmerine dhe menyrat e hartimit te politikes se zhvillimit dhe planit kombetar te frekuencave radio e televizive, si dhe per ruajtjen e parametrave te fiksuar ne plan, per te garantuar vazhdueshmerine e cilesine e sherbimit

KORRIK - SHTATOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- f. Hartimi i konkluzioneve paraprake dhe paraqitja per mendim Komisionit Parlamentar te Mjeteve te Informimit Publik e institucioneve dhe organizmave te tjera te interesuara

SHTATOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- g. Shqyrtimi i verejtjeve dhe perqatitja e konkluzioneve perfundimtare

SHTATOR - TETOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

2. Futja e teknikes se transmetimeve tokesore digitale (T-DAB dhe DVB-T)

- a. Hartimi i kushteve teknike te ofrimit te platformave te sherbimeve digitale tokesore radio e TV dhe procedures se licencimit

SHKURT 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- b. Organizimi i terheqjes se informacionit, mendimeve dhe kontributit te institucioneve e organeve te interesuara te vendit mbi zhvillimin e teknologjise digitale. Organizimi i konsultimeve me operatoret mbi kushtet teknike dhe procedurat

TETOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- c. Paraqitja e kushteve teknike te ofrimit te platformave te sherbimeve digitale tokesore radio e TV dhe procedures se licencimit per miratim Keshillit Kombtar te Radios dhe Televizionit

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

- d. Pergatitja e studimit per disa masa nxiteze per futjen e transmetimeve digitale radio e tv ne Shqiperi

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI EKONOMIK

- e. Bazuar ne kriteret e hartimit te Planit te Frekuencave, shpallja e frekuencave radio e kanaleve TV te caktuar per eksperimentimin e transmetimeve eksperimentale digitale radio e TV

DHJETOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

4. Pergatitja e kushteve te reja te licencave vendore, rajonale e kombetare

f. Sigurimi i asistences se organizmave te specializuara

TETOR 2004
KKRT

g. Hartimi i termave te references ne perputhje me synimet qe do te arrihen nepermjet kushteve te licences

TETOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

h. Organizimi i terheqjes se informacionit, mendimeve dhe kontributit te institucioneve e organeve te interesuara te vendit mbi kushtet e licences dhe organizimin e konkurrimit te kandidaturave

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

i. Organizimi i konsultimeve me operatoret mbi kushtet e kriteret e licencimit

NENTOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

j. Hartimi i kushteve paraprake te licencimit dhe paraqitja per mendim Komisionit Parlamentar te Mjeteve te Informimit Publik e institucioneve dhe organizmave te tjera te interesuara

DHJETOR 2004
DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

k. Shqyrtimi i verejtjeve dhe perqatitja e konkluzioneve perfundimtare

DHJETOR 2004

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

1. Pergatitja e kushteve te reja te licencave vendore, rajonale e kombetare, miratimi ne Keshill dhe publikimi

DHJETOR 2004

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE

5. Analiza e te ardhurave te realizuara ne tregun shqiptar te mediave, nepermjet monitorimit te reklamave per disa operatore radio e TV**QERSHOR 2004**

DEPARTAMENTI EKONOMIK
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE

6. Bazuar ne politiken e zhvillimit te transmetimeve radio e televizive, te percatiten propozimet per amendime te bazes ligjore**TETOR 2004**

DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I LICENCAVE
DEPARTAMENTI I PROGRAMEVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DEPARTAMENTI EKONOMIK
DREJTORIA E PERSONELIT

MONITORIMI I FREKUENCAVE

1. Kontrolli periodik i okupimit te brezave te frekuencave per transmetime radio e televizive ne te gjithe territorin e vendit

MAJ, DHJETOR 2004

DEPARTAMENTI TEKNIK

2. Kontrolli periodik i cilesise se sinjaleve te emetuara nga operatoret radio e televizive ne te gjithe territorin e vendit

MAJ, DHJETOR 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK

3. Azhornimi i regjistrat te stacioneve dhe dokumentacionit te raportimeve te monitorimit

PRILL 2004
DEPARTAMENTI TEKNIK

4. Identifikimi dhe lokalizimi i transmetimeve radio e televizive te paautorizuara

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI TEKNIK

5. Identifikimi e lokalizimi i interferencave ne sinjalet e transmetuara nga operatoret radio e televizive

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI TEKNIK

6. Koordinimi me organet rregullatore te vendeve fqinje, per mbrojtjen nga interferencat e stacioneve te huaja, ne zbatim te Planit Nderkombetar te Frekuencave

VAZHDIMISHT
DEPARTAMENTI TEKNIK

7. Rekrutimi i stafit te ri (planifikimi i frekuencave dhe inxhereria, kompetencat legale)

DREJTORIA E PERSONELIT
DEPARTAMENTI TEKNIK